

L I G J
Nr.7819, datë 27.4.1994

PËR PRONËSINË INDUSTRIALE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I

DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj siguron dhënien dhe mbrojtjen e të drejtave të Pronësisë Industriale për këto objekte:

1. Shpikjet dhe modelet e përdorimit.
2. Markat Tregëtare dhe të Shërbimit.
3. Dizenjot Industriale.
4. Emërtimet e origjinës.

Neni 2

Format e mbrojtjes

(1) Shpikjet dhe modelet e përdorimit mbrohen me anën e patentave, që lëshohen nga Zyra e Patentave.

Dizenjot industriale, markat tregtare e të shërbimit dhe emërtimet e origjinës mbrohen me anën e regjistrimit në Zyrën e Patentave.

Mbrojtja e referuar në këtë paragraf në lidhje me dizenjot industriale nuk përjashton ndonjë të drejtë tjetër të parashikuar me ligj, dhe në veçanti të drejtat e bazuara në ligjin për të Drejtën e Autorit.

(2) Klauzolat e këtij ligji janë njëlloj të vlefshme dhe të zbatueshme edhe për personat fizikë dhe juridikë të huaj:

(a) prej shteteve që janë palë-kontraktuese në traktate dhe konventa ndërkombëtare në fushën e pronësisë industriale, në të cilat bën pjesë edhe Republika e Shqipërisë;

(b) prej vendeve, me të cilat zbatohet parimi i reciprocitetit në fushën e pronësisë industriale, në kuadrin e marrëdhënieve dypalëshe ose në shkallë rajonale me efekt për Republikën e Shqipërisë.

Ekzistenca e reciprocitetit duhet të provohet nga pala e cila kërkon reciprocitet.

PJESA I

PATENTAT PËR SHPIKJET DHE MODELET E PËRDORIMIT

K R E U I

PATENTUESHMËRIA E SHPIKJEVE

Neni 3

Kushtet e patentueshmërisë

(1) Një shpikje është e patentueshme në qoftë së:

përbën një novacion;

përmban në vetvetë një hap shpikës (që nuk është i dukshëm për cilindo) dhe është e zbatueshme në industri.

(2) Paragrafi i mësipërm nuk zbatohet për :

- (a) zbulimet, teoritë shkencore dhe metodat matematike;
 - (b) krijimet estetike;
 - (c) skemat, rregullat dhe metodat që kërkojnë punë mendore, lojërat e ndryshme apo bizneset dhe programet për kompjutera;
 - (d) paraqitjen e informacioneve.
- (3) Klauzolat e paragrafit (2) përjashtojnë nga patentimi objektet dhe aktivitetet të cilat referohen në atë paragraf, vetëm në atë masë që një kërkesë për patentë ose një patentë ka të bëjë me ato objekte ose aktivitete si të tilla në vetvete.
- (4) Nuk lëshohet patentë për një shpikje, zbatim apo publikim i të cilës, bie në kundërshtim me rendin publik dhe normat morale.
- (5) Nuk lëshohet patentë për substanca të përfuara nëpërmjet transformimeve të brendshme bërthamore për qëllime ushtarake.
- (6) Nuk lëshohet patentë për shpikje të metodave kirurgjikale, diagnostike ose të metodave terapeutike të praktikuar tek trupi i njeriut apo i kafshëve, pasi ato konsiderohen si shpikje që nuk gjejnë zbatim në industri. Kjo klauzolë nuk zbatohet për substancat ose mjetet të cilat përdoren në ndonjë nga metodat mjekësore të mësipërme.
- (7) Nuk lëshohet patentë për shpikje që kanë të bëjnë me varietete të bimëve ose kafshëve, apo me procese thelbësore biologjike për prodhimin e bimëve ose kafshëve; kjo klauzolë nuk zbatohet për proceset mikrobiologjike ose për produktet në lidhje me to.

Neni 4 **Novacion**

- (1) Një shpikje konsiderohet se përbën novacion në qoftë se ajo nuk është pjesë e arritjeve të mëparshme. Për të përcaktuar një novacion, pjesët e arritjeve të mëparshme merren në konsideratë në mënyrë të shkëputur nga njëra tjetra.
- (2) Në arritjet e mëparshme përfshihet gjithçka që është bërë e mundur për t'u njohur publikisht me anën e publikimit, përdorimit ose demonstrimit të çdo lloji mënyre, para datës së depozitimit të kërkesës për njohjen e novaiconit, ose para datës së depozitimit më të hershëm të kësaj kërkesë (kur pretendohet për prioritet), e cila në vazhdim do të quhet datë prioritare.
- (3) Në arritjet e mëparshme përfshihet gjithashtu edhe përmbajtja e kërkesave për patentë të depozituara në Shqipëri ose të vlefshme për Shqipërinë, data e depozitimit ose data prioritare e të cilave është më e hershme se sa data që i referohet paragrafit të mësipërm, në atë masë që ato janë publikuar prej Zyrës së Patentave.

Neni 5 **Hap shpikës**

Një shpikje konsiderohet se përmban një hap shpikës në qoftë se, duke pasur parasysh arritjet e mëparshme, ajo nuk ka qenë e kapshme (e dukshme) për një specialist të profesionit në fjalë deri në datën e depozitimit të kësaj kërkesë, ose kur paraqitet pretendim për prioritet, deri në datën prioritare.

Neni 6 **Zbatueshmëri në industri**

Një shpikje quhet se është e zbatueshme në industri, kur ajo mund të realizohet ose të përdoret në ndonjë nga degët e industrisë. Termi industri kuptohet në sensin e tij të gjerë dhe mbulon veprimtarinë prodhuese dhe shërbimet.

Neni 7 **Periudha e imunitetit**

- (1) Nxjerrja në shesh e një informacioni që do të cenonte patentimin e një shpikjeje për të cilën pretendohet në një kërkesë, nuk ndikon në patentimin e shpikjes, në qoftë se informacioni bëhet i njohur jo më shumë se 12 muaj para datës së depozitimit të kërkesës, ose në rast të paraqitjes së një

pretendimi për prioritet, para datës prioritare, kur :

(a) ky publikim bëhet nga vetë shpikësi ose nga ndonjë person tjetër, i cili deri në datën e depozitimit të kërkesës ka patur të drejtën e pronësise së shpikjes në fjalë;

(b) ky publikim bëhet nga një Zyrtë Patentash dhe kur informacioni gjendet :

(i) në një kërkesë tjetër të depozituar nga shpikësi dhe që nuk duhej publikuar nga Zyra e Patentave, ose,

(ii) në një kërkesë të depozituar nga një palë e tretë pa dijeninë dhe lejen e shpikësit, palë e cila ka marrë informacion drejtpërdrejt ose tërthorazi nga vetë shpikësi;

(c) ky publikim bëhet nga një palë e tretë, e cila ka marrë informacion drejtpërdrejt ose tërthorazi nga shpikësi.

(2) Pasojat që rrjedhin nga paragrafi (1) i këtij neni, mund të apelojnë në çdo kohë.

(3) Për rastet kur zbatohet paragrafi (1) i këtij neni, pala që kërkon apelim, ka për detyrë të provojë ose të bëjë të mundur të arrihet në konkluzionin se, kushtet e parashikuara në paragrafin (1) të këtij neni, plotësohen të gjitha.

K R E U I I E DREJTA PËR PATENTË. EMRI I SHPIKËSIT

Neni 8

E drejta për patentë

(1) E drejta për patentë i përket shpikësit ose trashëgimtarëve të tij. Bashkëshpikësit kanë të drejta të barabarta midis tyre, përveç rasteve kur për këtë çështje kanë arritur një marrëveshje tjetër.

(2) Në rast se për të njëjtën shpikje janë depozituar dy ose më shumë kërkesa nga persona të ndryshëm dhe kur shpikjen e kanë bërë në mënyrë të pavarur nga njëri tjetri, atëherë e drejta për patentë i përket atij shpikësi, kërkesa e të cilit mban datën më të herëshme të depozitimit. Për rastet kur pretendohet për prioritet (në atë kuptim që ka ky term në kuadrin e Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronës Industriale dhe në përputhje të plotë me dispozitat e kësaj Konvente), e drejta për prioritet i takon atij personi, kërkesa për prioritet e të cilit mban datën më të herëshme të depozitimit.

Detyrimet e këtij paragrafi vlejnë për sa kohë që kërkesa në fjalë nuk tërhiqet ose abandonohet, nuk konsiderohet si e tërhequr ose e abandonuar, ose nuk refuzohet.

Neni 9

Shpikjet nga të punësuarit

(1)(a) Në rast se një shpikje bëhet në kuadrin e një marrëveshjeje apo të një kontrate pune, e drejta për patentë, përveç rasteve kur në kontratë është parashikuar ndryshe, i takon personit që ka porositur atë punë ose punëdhënësit.

(b) Kur shpikja ka një vlerë ekonomike shumë më të madhe se sa palët e kanë parashikuar në kohën e përfundimit të kontratës, i punësuari ka të drejtën e një shpërblimi të veçantë. Në mungesë të një marrëveshjeje midis palëve, masa e shpërblimit përcaktohet nga Gjykata.

(2)(a) Kur një punonjës, kontrata e punës e të cilit nuk e detyron atë të merret me aktivitete shpikëse bën një shpikje, duke përdorur të dhëna si dhe mjete të tjera të cilat i janë bërë të njohura nëpërmjet punësimit të tij në fushën e aktivitetit të punëdhënësit të tij, e drejta për patentë për këtë shpikje i përket punonjësit, përveç rasteve kur brenda një periudhe 4 muajore nga data në të cilën punëdhënësi i është paraqitur raporti i referuar në nënparagrafin (2)(b) ose nga data në të cilën punëdhënësi është njohur me shpikjen në mënyra të tjera, cilado qoftë data më e hershme, punëdhënësi njofton të punësuarin më anë të një deklarate e shkrim për interesin e tij për shpikjen.

(b) I punësuari, i cili ka bërë një shpikje të llojit që i referohet nënparagrafit (2)(a), do t'i paraqesë menjëherë punëdhënësit një raport për shpikjen më anë të një deklarate me shkrim.

(c) Në qoftë se brenda periudhës se referuar në nënparagrafin (2)(a), punëdhënësi bën një deklaratë ku shpreh interesin e tij për shpikjen, e drejta për patentë i përket atij që nga fillimi. I punësuari ka të drejtën e një shpërblimi që varet nga paga e tij, nga vlera ekonomike e shpikjes si edhe nga përfitimi që punëdhënësi merr nga kjo shpikje. Në mungesë të një marrëveshjeje midis palëve, masa e shpërblimit përcaktohet nga Gjykata.

(3) Çdo kontratë, e cila është më pak e favorshme për shpikësin se sa parashikimet e këtij neni konsiderohet si e paqenë.

Neni 10
Emri i shpikësit

(1) Në çdo botim të Zyrës së Patentave, në të cilin publikohen patentat ose kërkesat për patentë, është e detyrueshme të përmendet edhe emri i shpikësit (ose i shpikësave).

(2) Në rast se shpikësi kërkon me anën e një dokumenti të nënshkruar prej tij dhe të depozituar pranë Zyrës së Patentave, që emri i tij të mos publikohet, atëherë kjo zyrë duhet të respektojë vullnetin e shpikësit.

K R E U III
KËRKESAT DHE PROCEDURA PËR LËSHIMIN E NJË PATENTE

Neni 11
Përpilimi i kërkesës për patentë

- (1) Kërkesa për patentë duhet të përmbajë :
- (a) një kërkesë për marrjen e patentës;
 - (b) një përshkrim të shpikjes, për të cilën kërkohet patentë;
 - (c) një ose më shumë pretendime;
 - (d) vizatimet ose paraqitjet grafike, kur ato janë të nevojshme për të sqaruar thelbin e shpikjes dhe për të cilat bëhet fjalë në përshkrimin ose në pretendimet ;
 - (e) një përmbledhje të materialit ;
 - (f) një autorizim përfaqësimi, në qoftë se kërkesa paraqitet nëpërmjet një përfaqësuesi të autorizuar të patentave.
- (2) Kërkesa duhet të shoqërohet me pagesën e tarifave të caktuara.
- (3) Kërkesa duhet të përmbushë të gjitha kushtet e përcaktuara në Rregulloren e Zyrës së Patentave.

Neni 12
Data e depozitimit të kërkesës

(1) Datë e depozitimit të kërkesës për patentë quhet data në të cilën paraqitësi i kërkesës dorëzon pranë Zyrës së Patentave dokumentat, të cilat përmbajnë :

- (a) një kërkesë, ku shprehet qartë synimi për marrjen e patentës;
- (b) informacion mbi identitetin e paraqitësit të kërkesës;
- (c) një përshkrim dhe një ose më shumë pretendime, pavarësisht nëse janë në përputhje me kërkesat e tjera të këtij ligji dhe të Rregullores së Zyrës së Patentave.

(2)(a) Në rast se Zyra e Patentave konstaton se në kohën e marrjes së kërkesës mungon ndonjë nga elementët e përmendur në paragrafin (1) të këtij neni, atëherë kjo Zyrë duhet të njoftojë paraqitësin e kërkesës për të bërë plotësimet e duhura në përputhje me Rregulloren e Zyrës së Patentave.

(b) Kur paraqitësi i kërkesës bën plotësimet e duhura në përputhje me nënparagrafin (2)(a) të këtij neni, atëherë si datë e depozitimit të kërkesës njihet data e plotësimit të të gjithë dokumentacionit të nevojshëm. Në rast se paraqitësi i kërkesës nuk i kryen plotësimet e duhura në përputhje me atë nënparagraf, atëherë kërkesa konsiderohet e padepozituar.

(3) Paraqitësi i kërkesës për patentë ka të drejtë që, brenda një periudhe kohe tremujore të apelojë pranë Bordit të Apelit të Zyrës së Patentave vendimin e Zyrës së Patentave për mosdepozitimin e kërkesës së tij në lidhje me paragrafin (2) të këtij neni, duke paguar për këtë edhe tarifën e caktuar. Bordi i Apelit duhet ta shqyrtojë apelin brenda tre muajve dhe vendimi i tij do të jetë i formës së prerë.

(4) Kur kërkesës për patentë i akordohet një datë depozitimi në përputhje me paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, Zyra e Patentave duhet të njoftojë menjëherë për këtë paraqitësin e kërkesës.

Neni 13

Parashtrimi dhe përshkrimi

(1)(a) Në kërkesë shpikja duhet të parashtrohet në një mënyrë mjaft të qartë dhe të përmbajë ato të dhëna që i nevojiten një personi të profesionit në fjalë për ta vënë atë në zbatim.

(b) Kur kërkesa i referohet materialeve biologjike të riprodhueshme, të cilat nuk mund të parashtrohen në kërkesë në atë mënyrë, që t'i japin mundësinë një personi të profesionit në fjalë të realizojë zbatimin e shpikjes dhe kur këto materiale nuk janë të arritshme për t'u njohur nga ana e publikut, atëhere kërkesa duhet të plotësohet me anën e depozitimit të materialeve të tilla pranë një institucioni depozitues të caktuar për këtë qëllim.

(2)(a) Kërkesa duhet të përmbajë një përshkrim.

(b) Përshkrimi duhet të përmbajë elementët e përcaktuar në Rregulloren e Zyrës së Patentave dhe këta elementë duhet të paraqiten sipas një rregulli dhe renditjeje të përcaktuar në atë Rregullore.

Neni 14

Pretendimet

(1) Pretendimet përcaktojnë objektin dhe shkallën e mbrojtjes së kërkuar.

(2) Pretendimet duhet të paraqiten në mënyrë të qartë dhe koncize si dhe të jenë të mbështetura prej përshkrimit.

(3) Pretendimet duhet të jenë të paraqitura sipas mënyrës së përcaktuar në Rregulloren e Zyrës së Patentave.

Neni 15

Përmbledhja

Përmbledhja e materialit shërben vetëm për informim teknik. Ajo nuk merret në konsideratë kur është fjala për interpretimin e pretendimeve të paraqitura.

Neni 16

Uniteti i shpikjes

(1) Në kërkesë duhet të bëhet fjalë për një shpikje të vetme, ose për një grup shpikjesh, që lidhen në atë mënyrë, që të formojnë së bashku një koncept të përgjithshëm të vetëm shpikës.

(2) Në rast se kushti i paraqitur në paragrafin (1) të këtij neni nuk plotësohet, kjo nuk përbën arësye për zhvlerësimin e patentës.

Neni 17

Ndarja e kërkesës fillestare

(1) Paraqitësi i kërkesës fillestare mund ta ndajë kërkesën në dy ose më shumë kërkesa më vehtë, me kusht që secila prej kërkesave të ndara të mos dalë jashtë parashtrimit që bëhet në kërkesën fillestare.

(2) Për çdo kërkesë të ndarë, si datë depozitimi njihet data e depozitimit që mban kërkesa fillestare, ose kur pretendohet për prioritet, data prioritare.

(3) Dokumentet e prioritetit dhe të gjitha përkthimet e tjera të nevojshme, të cilat i janë paraqitur Zyrës së Patentave në lidhje me kërkesën fillestare, konsiderohen si të paraqitura për të gjitha kërkesat e ndara.

Neni 18

E drejta për prioritet

(1) Sipas Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronës Industriale, kërkesa mund të përmbajë

një deklaratë ku pretendohet për prioritet, si rrjedhim i depozitimit më të hershëm të një ose disa kërkesave kombëtare, rajonale ose ndërkombëtare nga paraqitësi i kërkesës ose nga trashëguesi i tij pranë ose në favor të ndonjë shteti palë pjesëmarrës në Konventën e sipërpërmendur.

(2) Kur kërkesa e përmban deklaratën për të cilën bëhet fjalë në paragrafin e mësipërm, Zyra e Patentave mund të kërkojë që paraqitësi i kërkesës të dorëzojë brenda një afati tremujor një kopje të vërtetuar të kërkesës më të hershme.

(3) Efekti i deklaratës së përmendur në paragrafin (1) të këtij neni do të jetë ai që parashikohet në Konventën e Parisit.

(4) Në rast se Zyra e Patentave konstaton se nuk janë plotësuar kërkesat e këtij neni, ajo njofton paraqitësin e kërkesës për të bërë korrigjimet e nevojshme brenda një afati të caktuar në Rregulloren e Zyrës së Patentave. Në rast se paraqitësi i kërkesës nuk i bën këto korrigjime, atëherë deklarata për të cilën bëhet fjalë në paragrafin (1) të këtij neni, konsiderohet e pavlefshme.

Neni 19

Amendamentet dhe korrigjimet. Tërheqja e kërkesës

(1) Paraqitësi i kërkesës ka të drejtë që me iniciativën e vet të bëjë amendamente apo korrigjime në kërkesën, brenda kohës së miratimit të patentës, duke paguar në këtë rast edhe tarifën e caktuar.

(2) Amendamentet dhe korrigjimet nuk mund të kapërcejnë caqet e asaj që është parashtruar që në fillim, në çastin e depozitimit të kërkesës.

(3) Amendamente dhe korrigjime mund të bëhen edhe me kërkesën e Zyrës së Patentave.

(4) Paraqitësi i kërkesës ka të drejtë të tërheqë kërkesën e tij në çdo kohë gjatë periudhës që ajo është në procesin e shqyrtimit.

Neni 20

Publikimi i kërkesave për patentë

(1)(a) Zyra e Patentave publikon të gjitha kërkesat për patenta që janë depozituar pranë saj.

(b) Nuk lejohet publikimi i kërkesave në rast se ato tërhiqen ose refuzohen para mbarimit të afatit prej 17 muajsh, që fillon nga data e depozitimit të kërkesës ose kur pretendohet për prioritet, nga data prioritare e kërkesës.

(c) Në qoftë se në kohën në të cilën duhej publikuar një kërkesë për patentë në përputhje me paragrafin e mëposhtëm, është lëshuar patentë për atë kërkesë, atëherë Zyra e Patentave nuk mund ta publikojë kërkesën, por duhet të bëjë publikimin e patentës, sipas mënyrës së përcaktuar dhe është e detyruar të lejojë çdo person të interesuar të inspektojë mbi atë kërkesë.

(2) Zyra e Patentave, duhet të publikojë çdo kërkesë të depozituar pranë saj menjëherë mbas mbarimit të afatit prej 18 muajsh nga data e depozitimit të kërkesës ose, kur pretendohet për prioritet, nga data prioritare. Megjithatë, kur para mbarimit të afatit prej 18 muajsh, paraqitësi i kërkesës për patentë dorëzon pranë Zyrës së Patentave një kërkesë me shkrim për publikimin para kohe të kërkesës së tij për patentë, Zyra e Patentave e bën atë publikim menjëherë.

(3) Publikimi i kërkesës për patentë i jep përkohësisht paraqitësit të kërkesës, që nga data e publikimit, po ato të drejta që do t'i jepte edhe publikimi i patentës përkatëse.

(4) Publikimi i kërkesës për patentë bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në Rregulloren e Zyrës së Patentave.

(5) Gjykata mund të vendosë pezullimin e çdo procesi të filluar në lidhje me akte të paautorizuara që kanë të bëjnë me një kërkesë të publikuar, derisa Zyra e Patentave të marrë vendimin për lëshimin ose refuzimin e patentës që kërkohet.

(6) Paragrafi (3) i këtij neni është i pavlefshëm, në qoftë se kërkesa për patentë tërhiqet ose refuzohet.

Neni 21

Shqyrtimi i kërkesës dhe lëshimi i patentës

(1) Zyra e Patentave shqyrton kërkesën e depozituar nëse ajo plotëson kërkesat e paragrafëve (2) , (3) , (4) , (5) , (6) dhe (7) të nenit 4 si dhe ato të neneve 12, 14, 15, 16 dhe 17. Zyra e Patentave nuk bën shqyrtimin thelbësor të kërkesës për patentë, duke mos i bërë shpikjes një vlerësim në përputhje me kërkesat e neneve 4(1), 5, 6 dhe 7. Në këtë drejtim, patentat lëshohet pa një garanci vlefshmërisë së saj.

(2) Në qoftë se rezultatet e shqyrtimit të kërkesës janë pozitive (domethënë të gjitha kërkesat e përmendura në paragrafin (1) të këtij neni plotësohen), Zyra e Patentave, lëshon patentën përkatëse, kundrejt pagesës së tarifës së caktuar. Vendimi i Zyrës së Patentave për miratimin e patentës bëhet brenda katër muajve prej datës së publikimit të kërkesës.

(3) Në qoftë se kërkesa nuk i plotëson ose i plotëson pjesërisht kërkesat e paragrafit (1) të këtij neni, Zyra duhet të njoftojë paraqitësin e kërkesës, duke specifikuar mospërputhjet dhe duke caktuar një periudhë tremujore, për të marrë një përgjigje për rregullimin e tyre. Në qoftë se paraqitësi i kërkesës nuk i kryen korrigjimet dhe plotësimet e specifikuar prej Zyrës së Patentave brenda afatit, kërkesa refuzohet.

(4) Vendimi i marrë në përputhje me paragrafin (4) të këtij neni, mund të apelohej në Bordin e Apelit të Zyrës së Patentave, brenda një periudhe prej tremujsh kundrejt një pagese të caktuar. Paraqitësi i kërkesës ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës për të apeluar kundër vendimit të Bordit të Apelit brenda një afati gjashtëmujor.

(5) Pas vendimit për të lëshuar patentën, sa më shpejt që të jetë e mundur, Zyra e Patentave publikon njoftimin për dhënien e patentës dhe specifikimet e tjera sipas rregullave të caktuara.

Neni 22

Regjistri i patentave

(1) Zyra e Patentave mban një regjistrë për patentat, në të cilin regjistrohen të gjitha patentat, sipas rradhës së lëshimit.

(2) Në regjistrin e patentave regjistrohen të gjitha faktet dhe të dhënat që përbëjnë dhe kanë lidhje me patentën, sipas mënyrës së përcaktuar, si edhe korrigjimet, amendamentet, ndryshimet e pronësisë si dhe çështje të tjera që Zyra e Patentave detyrohet t'i regjistrojë sipas këtij ligji.

(3) Regjistri i patentave është dokument themelor (prima facie) për të gjitha çështjet që ky ligj udhëzon apo autorizon të mbahen në të.

(4) Regjistri i patentave është i hapur për inspektim publik në varësi të rregullave të përcaktuara.

(5) Zyra e Patentave lëshon kopje të vërtetuara për shënimet e ndryshme të bëra në Regjistrin e Patentave për çdo person që interesohet, kundrejt një pagese të caktuar. Këto kopje të vërtetuara janë të pranueshme si dëshmi në të gjitha gjykatat dhe proceset gjyqësore, pa qenë nevoja që të provohet më tej autenticiteti i tyre ose që të paraqitet origjinali.

Neni 23

Patentat sekrete

(1) Kërkesat për patentë në lidhje me shpikjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe sigurimin e vendit, konsiderohen sekrete dhe depozitohen në Ministrinë e Mbrojtjes.

(2) Kur në Zyrën e Patentave paraqitet një kërkesë për një shpikje e cila gjykohet sekrete nga Zyra e Patentave, ajo njofton për këtë paraqitësin e kërkesës dhe e fton atë të shprehë pikëpamjen e tij në lidhje me konsideratat e Zyrës brenda një periudhe të caktuar:

(a) në qoftë se paraqitësi i kërkesës aprovon konsideratat e Zyrës, kërkesa dërgohet për t'u analizuar në Ministrinë e Mbrojtjes;

(b) në qoftë se paraqitësi i kërkesës nuk aprovon konsideratat e Zyrës dhe vërteton opinionin e tij me prova, të cilat pranohen nga Zyra e Patentave, atëherë kjo e fundit fillon procedurën për shqyrtimin dhe lëshimin e patentës në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

(c) në qoftë se paraqitësi i kërkesës nuk aprovon konsideratat e Zyrës dhe dështon në vërtetimin e opinionit të tij atëherë Zyra merr një vendim për inkompetencën e saj dhe dërgon kërkesën në Ministrinë e Mbrojtjes për t'u analizuar prej saj.

(3) Në qoftë se Ministria e Mbrojtjes gjykon se shpikja nuk konsiderohet sekrete, atëherë

kërkesa dërgohet në Zyrën e Patentave, e cila e trajton atë në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

(4) Të gjitha procedurat në lidhje me trajtimin e kërkesave për patenta sekrete dhe patentave sekrete bëhen në përputhje me rregulla të veçanta.

(5) Në qoftë se mbas miratimit të një patente për një shpikje sekrete, Ministria e Mbrojtjes vendos që shpikja të mos konsiderohet më si sekrete atëherë e gjithë dosja në lidhje me këtë patentë dërgohet në Zyrën e Patentave. Mbas marrjes në dorëzim të një dosjeje të tillë, Zyra e Patentave kryen regjistrimin e patentës në Regjistrin e Patentave, lëshon patentën dhe bën publikimin e saj sipas paragrafit (6) të nenit 22.

(6) Personat fizikë dhe juridikë vendas mund të kërkojnë patentë jashtë Republikës së Shqipërisë, për shpikjet sekrete, vetëm me miratimin e Ministrisë së Mbrojtjes.

Neni 24

Shfrytëzimi i shpikjeve sekrete

(1) Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Rendit Publik kanë të drejtën ekskluzive të kryejnë dhe të shfrytëzojnë shpikjet sekrete.

(2) Paraqitësit të kërkesës për patentë ose pronarit të patentës së shpikjes sekrete i akordohet si kompensim një shpërblim material i caktuar prej dikasterit përkatës që disponon shpikjen.

(3) Për sasinë e shpërblimit të referuar në paragrafin (2) të këtij neni lidhet një marrëveshje midis palëve. Në rast se nuk arrihet një marrëveshje e tillë, paraqitësi i kërkesës ose pronari i patentës ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës kompetentë që të përcaktojë madhësinë e shpërblimit.

Neni 25

Inspektimi i dosjeve

(1) Dosja e një kërkesë për patentë mund të inspektohet para lëshimit të patentës vetëm në rast se për këtë jepet leje me shkrim nga paraqitësi i kërkesës.

(2) Në rast se një kërkesë tërhiqet në përputhje me nenin 20(4), atëherë dosja e saj mund të inspektohet vetëm po qe se është dhënë leje me shkrim nga personi që ka tërhequr kërkesën.

Neni 26

Kundërshtimet ndaj lëshimit të patentës

(1) Çdo person i interesuar ka të drejtë që, brenda nëntë muajve prej datës së njoftimit zyrtar të lëshimit të patentës, të depozitojë pranë Bordit të Apelimit të Zyrës së Patentave, një kundërshtim ndaj lëshimit të patentës, kundrejt një pagese të caktuar. Kundërshtimi duhet të paraqitet me shkrim në dy kopje.

(2) Pranë Bordit të Apelimit mund të depozitohen kundërshtime ndaj lëshimit të patentës vetëm në qoftë se nuk janë respektuar kërkesat e paragrafëve (2), (3), (4), (5), (6) të nenit 4, e nenit 9, e paragrafit (1) të nenit 14 të paragrafit (2) të nenit 20.

(3) Sipas paragrafit (1) të këtij neni, një kopje e kundërshtimit i dërgohet paraqitësit të kërkesës i cili duhet të përgatisë argumentat mbrojtës brenda tre muajve. Me kërkesën e paraqitësit të kërkesës ky afat mund të shtyhet edhe një muaj më shumë. Bordi i Apelimit duhet ta shqyrtojë kundërshtimin brenda tre muajve nga data e marrjes së argumentave mbrojtës prej paraqitësit të kërkesës. Paraqitësi i kërkesës dhe paraqitësi i kundërshtimit duhet të njoftohen për shqyrtimin e kundërshtimit 30 ditë përpara datës së caktuar për procedurën e gjyimit të çështjes. Të dyja palët kanë të drejtë të marrin pjesë në procedurën e gjyimit të çështjes si dhe të paraqesin argumentat e tyre në formën e materialeve të dokumentuara dhe të shpjegimeve gojore.

(4) Në përputhje me rezultatet e shqyrtimit të kundërshtimit, Bordi i Apelimit miraton një vendim ose për shfuqizimin e plotë apo të pjesshëm të patentës, ose për hedhjen poshtë të kundërshtimit.

(5) Vendimi i marrë prej Bordit të Apelimit të Zyrës së Patentave mund të apelohej nga secila palë e interesuar brenda gjashtë muajve.

K R E U IV EFEKTET E PATENTËS

Neni 27

Të drejtat që jep një patentë

(1) Kur patenta ka të bëjë me një produkt, pronari i patentës ka të drejtë të ndalojë palët e treta, që pa autorizimin e tij të kryejnë veprimet e mëposhtme :

- (a) të prodhojnë produktin duke përdorur shpikjen në fjalë;
- (b) të ofrojnë ose të hedhin në treg një produkt që përmban në vetvete shpikjen që mbrohet, të përdorin, të importojnë ose të grumbullojnë këtë produkt për ta ofruar ose për ta hedhur në treg;
- (c) të nxisin persona të tretë në kryerjen e ndonjë prej akteve të përmendura në dy nënparagrafët e mësipërme.

(2) Kur patenta ka të bëjë me një proces teknologjik, pronari i patentës ka të drejtë të ndalojë palët e treta, që pa autorizimin e tij të kryejnë veprimet e mëposhtme:

- (a) të përdorin atë proces, i cili përbën subjektin e patentës;
- (b) veprimet e përmendura në paragrafin (1)(b) të këtij neni, kur është fjala për ndonjë produkt që prodhohet drejtpërdrejt nga përdorimi i atij procesi, edhe në rast se për produktin në fjalë nuk mund të merret patentë;

(c) të nxisin persona të tretë në kryerjen ndonjërit prej akteve të mësipërme.

(3) Pronari i një patente nuk ka të drejtë të pengojë palët e treta, që pa autorizimin e tij të kryejnë veprimet e përmendura në paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni në rrethanat e mëposhtme :

(a) kur veprimi ka të bëjë me një produkt, i cili është hedhur në treg nga pronari i patentës ose me lejen e tij, me kusht që veprimi të jetë kryer pas produkti të jetë hedhur në treg, në Shqipëri ose në ndonjë tërritor tjetër të përcaktuar në marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe të Republikës së Shqipërisë;

(b) kur veprimi kryhet privatisht, jo për qëllime tregtare, me kusht që ai të mos cenojë në mënyrë të ndjeshme interesat ekonomike të pronarit të patentës;

(c) kur veprimi kryhet thjesht për qëllim eksperimentimi ose në fushën e kërkimeve shkencore;

(d) kur veprimi ka të bëjë me përgatitjen e atypëratyshme (të paqëllimshme) në raste të shkëputura në një farmaci ose nga ndonjë mjek i një medikamenti sipas një recete të caktuar, si dhe me aktet e tjera që çojnë në përgatitjen e preparatit në atë mënyrë.

(4) Patenta gjithashtu i jep të drejtë pronarit të saj të pengojë palët e treta t'i japin apo t'i ofrojnë një personi, përveç palëve që kanë fituar të drejtën e shfrytëzimit të shpikjes së patentuar, mjete që lidhen me ndonjë element të shpikjes, posaçërisht për realizimin e shpikjes, kur pala e tretë ka dijeni ose kur kjo bëhet e qartë nga rrethanat se ato mjete janë të paracaktuara për realizimin e shpikjes në fjalë. Kjo dispozitë nuk zbatohet në rast se këto mjete përbëjnë objekte të zakonshme tregtare dhe kur rrethanat e ofertës për këto mjete nuk përbëjnë nxitje të qëllimshme të personave të tjerë në shkeljen e të drejtave që jep patenta.

Neni 28

Kohëzgjatja e patentës dhe detyrimi financiar

(1) Kohëzgjatja e një patente është 20 vjet nga data e depozitimit të kërkesës.

(2) Mbajtja e patentës është e kushtëzuar me pagesën e një tarife të caktuar, e cila është e detyrueshme për }do vit dhe duhet të likuidohet brenda ditës që korrespondon me datën e depozitimit të kërkesës.

(3) Shlyerja e pagesës mund të kryhet brenda gjashtë muajve pas afatit të përcaktuar në paragrafin (2) të këtij neni, duke paguar një tarifë shtesë për vonesën.

(4) Në rast se nuk zbatohen paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni patenta bëhet e pavlefshme që ditën që ka mbaruar afati i pagesës.

(5) Kohëzgjatja e patentave për shpikje që kanë të bëjnë me prodhime farmaceutike, me kërkesën e pronarit të patentës, mund të shtrihet edhe për një afat kohor shtesë i cili mund të jetë deri në 5 vjet.

Neni 29
Shkalla e mbrojtjes

(1) Shkalla e mbrojtjes që siguron një patentë, përcaktohet nga pretendimet e paraqitura, të cilat interpretohen duke u bazuar në përshkrimin dhe vizatimet e paraqitura, në mënyrë që të bëhet një kombinim i drejtë i mbrojtjes së interesave të pronarit të patentës dhe të palëve të treta.

(2) Për periudhën deri në lëshimin e patentës, shkalla e mbrojtjes që jep paraqitja e kërkesës për patentë përcaktohet në varësi të pretendimeve të depozituara, të cilat pasqyrohen në publikimin që bëhet në përputhje me nenin 21 të këtij ligji. Megjithatë, mbas lëshimit të patentës, duke përfshirë edhe amendamentet që i bëhen për pjesët që zhvlerësohen, ajo përcakton me fuqi prapavepruese mbrojtjen që i është dhënë depozitimit të kërkesës për patentë, dhe në mënyrë të tillë, që me lëshimin e patentës kjo mbrojtje nuk zgjerohet më tej.

(3) Në përcaktimin e shkallës së mbrojtjes duhen marrë në konsideratë të gjitha deklaratat që kufizojnë spektrin e pretendimeve të bëra nga paraqitësi i kërkesës ose nga pronari i patentës gjatë procedurave që kanë të bëjnë me lëshimin ose vlefshmërinë e patentës.

Neni 30
Përdoruesit e parakohshëm

(1) Të drejtat në kuadrin e patentës nuk kanë efekt kundër atyre personave, të cilët me dëshirën e mirë të tyre, për qëllime të ndërmarrjes ose të shoqërisë së tyre, brenda Shqipërisë, kanë përdorur shpikjen ose janë në procesin e përgatitjeve serioze dhe efektive për përdorimin e asaj shpikjeje, para datës së depozitimit, ose, në rastet kur është paraqitur kërkesë për prioritet, para datës prioritare të kërkesës në të cilën lëshohet patenta.

Këta persona kanë të drejtë që për qëllime të ndërmarrjes ose të shoqërisë së tyre, të vazhdojnë përdorimin ose përgatitjet për përdorim.

(2) E drejta e përdorimit të parë vetëm mund të transferohet ose të pasohet se bashku me ndërmarrjen ose shoqërinë, ose me atë pjesë të ndërmarrjes ose të shoqërisë në të cilën është realizuar përdorimi ose janë bërë përgatitjet për përdorim.

Neni 31
Kufizimi i të drejtave lidhur me mjetet e transportit dhe mallrat tranzit

Të drejtat në kuadrin e patentës nuk shtrihen në përdorimin e një shpikjeje të patentuar mbi mjetet e huaja të transportit detar, ajror apo tokësor, të cilat përkohësisht ose aksidentalisht hyjnë në ujrat, hapësirën ajrore apo tokësore të Shqipërisë, përveç rasteve kur shpikja e patentuar përdoret ekskluzivisht për nevojat e mjeteve të transportit detar, ose në ndërtimin ose funksionimin e avionëve, mjeteve të hapësirës kozmike ose mjeteve të transportit tokësor.

K R E U V
NDRYSHIMI I PRONËSISË DHE BASHKËPRONËSIA E KËRKESËS PËR PATENTË OSE E PATENTËS

Neni 32

Ndryshimi i pronësisë së kërkesës për patentë ose i patentës

(1) Çdo kontratë lidhur me një kërkesë për patentë ose me një patentë duhet bërë me shkrim dhe duhet të nënshkruhet nga palët kontratuese. Në rast të kundërt kontrata nuk është e vlefshme.

(2) Çdo ndryshim në pronësinë e një kërkesë për patentë ose të një patentë duhet regjistruar në regjistrin e patentave kundrejt tarifës së caktuar. Pronari i patentës ka të drejtë të fillojë proces gjyqësor lidhur me atë patentë, vetëm në rast se ndryshimi i pronësisë është regjistruar në regjistrin e patentave. Zyra e Patentave duhet të bëjë publikimin për ndryshimet në pronësinë e patentave.

Transferimi ligjor i kërkesës për patentë ose i patentës

Në rast se elementët kryesorë të shpikjes, të pretenduara në një kërkesë për patentë ose në një patentë, merren nga një shpikje tjetër, patenta e të cilës në bazë të neneve 9 e 10 të këtij ligji i takon një personi tjetër, atëherë ky i fundit ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata të transferojë në emrin e vet kërkesën për patentë ose patentën.

Bashkëpronësia e kërkesës për patentë ose e patentës

(1) Në rast se dy ose më shumë persona sëbashku paraqesin një kërkesë për patentë, secili prej tyre ka të drejtë të bëjë transferimin e pjesës së vet të kërkesës për patentë ndërsa, tërheqja e kërkesës për patentë ose lidhja e kontratës për licencë me palë të treta mund të bëhet vetëm me vendim unanim nga të gjithë bashkëpronarët e kësaj kërkesë.

(2) Në rast se kemi të bëjmë me bashkëpronarë të një patente, secili prej tyre me vete, ka të drejtë të bëjë transferimin e pjesës së vet të patentës, ose të fillojë një proces gjyqësor kundër shkeljeve të të drejtave të patentës nga një person që shfrytëzon shpikjen e patentuar në Shqipëri, pa miratimin e bashkëpronarëve të tjerë. Nga ana tjetër, shfrytëzimi i shpikjes së patentuar në Shqipëri nga njëri prej bashkëpronarëve nuk kërkon miratimin e pjesës tjetër të tyre. Dorëheqja prej patentës ose lidhja e kontratave për licencë me palë të treta, mund të bëhet vetëm me vendim unanim nga të gjithë bashkëpronarët e asaj patente.

(3) Dispozitat e paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni zbatohen vetëm në ato raste, kur nuk ekzistojnë marrëveshje për të kundërtën midis bashkëpronarëve të kërkesës për patentë ose të patentës.

K R U E V I**KONTRATAT E LICENCEVE. GADISHMËRIA PËR DHËNIE LICENCE.****Kontratë licence**

(1) Me termin “kontratë licence” në këtë ligj nënkuptohet çdo kontratë, me anën e së cilës njëra palë (licencori) i jep palës tjetër (të licencuarit) miratimin që pala tjetër të kryejë në Shqipëri secilin nga veprimet e përmendura në nenin 28 të këtij ligji, lidhur me shpikjen që pretendohet në patentë ose në kërkesën për patentë.

(2) Kontrata e licencës bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga palët në kontratë. Në rast të kundërt kontrata quhet e pavlefshme.

(3) Lidhja e kontratës së licencës mund të regjistrohet në regjistrin e patentave kundrejt pagesës së tarifës së caktuar. I licencuari ka të drejtë të fillojë proces gjyqësor në lidhje me kontratën e licencës, vetëm në rast se kontrata është e regjistruar në regjistrin e patentave.

(4) Kontratat e licenceve dhe të shitjeve të patentave sekrete mund të nënshkruhen vetëm në qoftë se për këtë jepet miratim me shkrim nga Ministria e Mbrotjtjes, Ministria e Rendit Publik ose Shërbimi Informativ Kombëtar.

(5) Në rast se pronari i patentës nuk paguan tarifën e përcaktuar në përputhje me nenin 29 të këtij ligji dhe në Zyrën e Patentave është regjistruar një licencë në favor të një personi të tretë, atëherë Zyra e Patentave e njofton personin e licencuar se nuk është paguar tarifa dhe se ai mund ta paguajë atë tarifë brenda gjashtë muajve nga data e njoftimit, me qëllim që të ruajë vlefshmërinë e licencës së regjistruar. Në rast mosmarrëveshjeje për sigurimin e të drejtave të regjistruara(e licencës) të një personi të tretë, Gjykata mund të vendosë, në rast se e gjykon si të domosdoshme për të siguruar atë të drejtë, që patenta t’i transferohet personit, në emër të të cilit është regjistruar licenca.

Të drejtat e të licencuarit

(1) Në rast se në kontratën e licencës mungojnë dispozitat për kundërvajtje me atë kontratë,

atëhere, për këtë kontratë janë të vlefshme veprimet e përcaktuara në nenin 28 të këtij ligji pa kufizim në kohe, në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe në të gjitha fushat ku gjen zbatim shpikja.

(2) Në rast se në kontratën e licencës mungojnë dispozitat për kundërvajtje me atë kontratë, atëhere i licencuari nuk ka të drejtë t'u japë palëve të treta miratimin e tij, që ata të kryejnë në territorin e Shqipërisë, lidhur me shpikjen, ndonjë nga veprimet që përmenden në nenin 28 të këtij ligji.

Neni 37

Të drejtat e licencorit

(1) Në rast se në kontratën e licencës mungojnë dispozitat për kundërvajtje me atë kontratë, atëhere licencori ka të drejtë t'i japë një personi të tretë miratimin e vet për të kryer në territorin e Shqipërisë, lidhur me shpikjen, veprimet e përmendura në nenin 28, dhe nuk është i detyruar të mos i kryejë vetë ato veprime në territorin e Shqipërisë.

(2) Në rast se në kontratën e licencës është përcaktuar ekskluziviteti i licencës dhe në rast se në atë kontratë nuk thuhet shprehimisht e kundërta, atëhere licencori nuk ka të drejtë t'u japë palëve të treta miratimin për kryerjen në territorin e Shqipërisë, lidhur me shpikjen, të veprimeve të përcaktuara në nenin 28 të këtij ligji dhe as t'i kryejë vetë ato veprime.

Neni 38

Gadishmëria për dhënie licence

(1) Në rast se pronari i patentës i lëshon Zyrës së Patentave një dokument me shkrim se ai është i gatshëm të lejojë persona të tjerë të përdorin shpikjen si persona të licencuar kundrejt një kompensimi të caktuar, atëhere, pas paraqitjes së këtij dokumenti, nga detyrimi financiar zbritet vlera përkatëse, ashtu siç parashikohet në Rregulloren e Zyrës së Patentave.

(2) Me dëshirën e pronarit të patentës, ky dokument mund të tërhiqet në çdo kohë, duke i paraqitur për këtë qëllim një njoftim me shkrim Zyrës së Patentave, me kusht që deri në atë kohë, asnjë person të mos ketë njoftuar pronarin e patentës për qëllimin e tij për ta përdorur atë shpikje.

(3) Dokumenti i gadishmërisë për dhënie licence nuk mund të paraqitet për aq kohë sa në regjistrin e patentave është regjistruar një licencë ekskluzive.

(4) Në bazë të dokumentit të lartpërmendur çdo person gëzon të drejtën ta përdorë shpikjen si person i licencuar duke plotësuar kushtet e parashtruara në Rregulloren e Zyrës së Patentave. Çdo licencë që merret në mënyrë të tillë konsiderohet si një licencë kontratuese (kontratë licencë).

(5) Kërkesa për të regjistruar një licencë ekskluzive në regjistrin e patentave nuk do të pranohet, në rast se më parë është paraqitur dokumenti i gadishmërisë për dhënie licence. Për t'u bërë i mundur regjistrimi i licencës ekskluzive, më parë duhet të bëhet tërheqja e këtij dokumenti nga pronari i patentës.

K R E U VII

LICENCAT JOVULLNETARE

Neni 39

Licencat jovullnetare

(1) Sipas kërkesës së çdo personi, që provon se është i aftë ta vërë në zbatim shpikjen në territorin e Shqipërisë, kërkesë kjo e bërë pas përfundimit të një afati prej katër vjetësh nga data e depozitimit të kërkesës për patentë ose tre vjet nga data e lëshimit të patentës, në varësi me atë se cila është data më e vonëshme, Zyra e Patentave mund të japë një licencë joekskluzive, jovullnetare, në rast se shpikja e patentuar nuk është shfrytëzuar ose nuk është venë në punë aq sa duhet në Shqipëri. Dhënia e licencave jovullnetare duhet të shoqërohet me një urdhër për likuidimin në favor të pronarit të patentës të një pagese të përcaktuar në mënyrë të arsyeshme.

(2) Pavarësisht nga paragrafi (1) i këtij neni, Zyra e Patentave nuk jep licencë jovullnetare në rast se ajo është e bindur se ekzistojnë arsye të justifikueshme që shpikja e patentuar nuk po jep rezultate ose se ajo nuk po funksionon si duhet në territorin e Shqipërisë.

(3) Para se të marrë vendimin për dhënien e një licence jovullnetare, Zyra e Patentave duhet t'u japë mundësi si pronarit të patentës, ashtu edhe personit që kërkon licencën jovullnetare, të paraqesin argumentat e tyre.

(4) Çdo licencë jovullnetare mund të anulohet kur rrethanat, të cilat kishin çuar në miratimin e saj nuk ekzistojnë më, duke marrë parasysh interesat legjitime të pronarit të patentës dhe të të licencuarit. Rishqyrtimi i rrethanave aktuale bëhet me kërkesën e pronarit të patentës.

Neni 40

Shfrytëzimi nga ana e Qeverisë apo nga palët e treta të autorizuar nga Qeveria

Në rast se e kërkojnë interesat e sigurimit Kombëtar apo të sigurisë publike, Ministri mund të autorizojë edhe pa miratimin e pronarit të patentës apo të paraqitësit të kërkesës, me anë të një njoftimi të botuar në Gazetën Zyrtare, një agjenci qeveritare, apo një person të caktuar, të cilët përmenden në njoftimin në fjalë, të realizojnë, të përdorin, apo të shesin shpikjen për të cilën është paraqitur kërkesa për patentë, apo është dhënë patenta kundrejt një pagese të mjaftueshme që i duhet dhënë pronarit të patentës ose paraqitësit të kërkesës. Vendimi i ministrit mund të apelohej në Gjykatë.

K R E U VIII SHKELJET

Neni 41

Aktet që përbëjnë shkelje

(1) Sipas këtij ligji, kryerja e ndonjërit prej veprimeve të përmendura në nenin 28(1)(2) dhe (4) të këtij ligji në territorin e Shqipërisë, prej personave të ndryshëm nga pronari i patentës dhe pa lejen e tij, që ka lidhje me produktin ose procesin që mbron patenta, përbën shkelje të patentës.

(2) Sipas këtij ligji, kryerja e ndonjërit prej veprimeve të përmendura në nenin 28(1)(2)(4) të këtij ligji në territorin e Shqipërisë, prej personave të ndryshëm nga paraqitësi i kërkesës dhe pa lejen e tij, që ka lidhje me produktin ose procesin që është në mbrojtje të përkohëshme, sipas nenit 21(3) të këtij ligji nga publikimi i një kërkesë për patentë, përbën shkelje të kësaj mbrojtjeje të përkohëshme.

Neni 42

Procedurat në rast shkeljesh

(1) Pronari i patentës ose paraqitësi i kërkesës kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës, e cila do të fillojë proces gjyqësor kundër çdo personi që ka shkelur ose po shkel patentën ose mbrojtjen e përkohëshme që siguron publikimi i një kërkesë për patentë.

Pronari i patentës ose paraqitësi i kërkesës kanë të njëjtën të drejtë edhe kundër personave që kanë kryer ose mund të kryejnë veprime që mund të çojnë në shkelje ("shkelje eminente"). Procesi gjyqësor nuk mund të hapet mbas një periudhe pesë vjeçare, pasi ka ndodhur shkelja.

(2) (a) Në rast se pronari i patentës provon se ka ndodhur ose po ndodh një shkelje, në vendimin e gjykatës caktohet dëmshpërblimi përkatës dhe gjykata merr masa për parandalimin e shkeljeve të tjera që përcaktohen në legjislacionin e përgjithshëm.

(b) Në rast se pronari i një patente provon rrezikun e një shkeljeje eminente, ai ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës, e cila urdhëron marrjen e masave që parandalojnë shkeljen, si dhe hapa të tjerë që përcaktohen në legjislacionin e përgjithshëm.

(3) (a) Në rast se në kontratën e licencës nuk është parashikuar ndryshe, atëherë i licencuari ka të drejtë t'i kërkojë pronarit të patentës, që ky i fundit t'i drejtohet gjykatës për çdo shkelje që konstatohet prej tij. I licencuari duhet të propozojë edhe dëmshpërblimin që dëshiron.

(b) Në rast se pronari i patentës ka marrë një kërkesë prej të licencuarit për t'iu drejtuar gjykatës, por refuzon ose nuk i drejtohet gjykatës brenda tre muajve nga data e marrjes së kërkesës, atëherë i licencuari ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës në emrin e vet, pasi ka njoftuar pronarin e patentës për një gjë të tillë. Pronari i patentës ka të drejtë të marrë pjesë në atë proces me statusin e personit të tretë të interesuar.

(c) Edhe para mbarimit të afatit tremujor të përmendur në paragrafin (3)(b) të këtij neni,

gjykata, me kërkesë të të licencuarit, ka të drejtë të urdhërojë marrjen e masave për parandalimin e shkeljes ose të pengojë vazhdimin e saj, në rast se i licencuari provon se duhen marrë masa të menjëhershme për të shmangur dëme më të mëdha.

(4) Në rast se patenta ka lidhje me një proces prodhimi, që kryhet për të përfutur një produkt të caktuar, atëherë i padituri për shkelës detyrohet të provojë se produkti nuk është prodhuar me anë të procesit në fjalë, në rast se plotësohet një nga kushtet e mëposhtëme :

(a) produkti është i ri, ose

(b) kur ka shumë të ngjarë që produkti të jetë realizuar duke përdorur procesin në fjalë, dhe kur pronari i patentës nuk ka mundur që me përpjekjet e veta të identifikojë procesin që është përdorur.

Neni 43

Vertëtim për mungese shkeljeje

(1) Çdo person i interesuar ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës kundër pronarit të patentës, duke kërkuar që gjykata të shpallë se kryerja e një veprimi të dhënë nuk ka përbërë shkelje të patentës, me përjashtim të rastit kur plotësohen kërkesat e paragrafit (4) të këtij neni.

(2) Në rast se personi që bën këtë kërkesë provon se veprimi në fjalë nuk përbën shkelje të patentës, atëherë Gjykata shpall një vendim për mungesë shkeljeje.

(3) Pronari i patentës ka për detyrë të njoftojë të licencuarit për procedurat në fjalë. Të licencuarit kanë të drejtë të marrin pjesë në këto procedura me statusin e personave të tretë të interesuar, përveç rasteve kur në kontratën e licencës thuhet ndryshe.

(4) Në rast se veprimi në fjalë është bërë objekt i procedurave për shkelje atëherë i padituri nuk ka të drejtë të fillojë edhe ai procedurat për vertetimin e mungesës së shkeljes.

K R E U I X

NDRYSHIMET NË PATENTAT. DORËHEQJA DHE ZHVLERËSIMI.

Neni 45

Ndryshimet në patenta

(1) Pronari i një patente ka të drejtë t'i kërkojë Zyrës së Patentave të bëjë ndryshime në atë patentë, me synim kufizimin e shkallës së mbrojtjes që siguron patenta.

(2) Pronari i një patente ka të drejtë t'i kërkojë Zyrës së Patentave të bëjë ndryshime në atë patentë, për korrigjimin e gabimeve apo të pasaktësirave të bëra pa qëllim.

Në qoftë se kryerja e një ndryshimi do të sillte rritjen e shkallës së mbrojtjes që siguron patenta, ajo kërkesë për një ndryshim të tillë, nuk pranohet, në rast se kanë kaluar dy vjet nga koha e dhënies së patentës, dhe në rast se ndryshimi cenon të drejtat e palëve të treta, të cilat janë bazuar në patentë ashtu siç është publikuar.

(3) Kërkesa për të bërë ndryshime në patentë, në përputhje me paragrafin (1) dhe (2) të këtij neni nuk pranohet, në rast se parashtrimi i patentës me ndryshimet e kërkuara kalon caqet e parashtrimit që përmban kërkesa e depozituar për atë patentë.

(4) Në rast se Zyra e Patentave bën ndryshime në patentë, sipas paragrafeve (1) ose (2) të këtij neni, atëherë kjo Zyrë detyrohet të bëjë publikimin e këtyre ndryshimeve.

Neni 45

Dorëheqja

(1) Pronari i patentës ka të drejtë të heqë dorë prej patentës, duke i paraqitur për këtë Zyrës së Patentave një deklaratë me shkrim. Ky veprim mund të kufizohet edhe për një ose disa pretendime të paraqitura në patentë.

(2) Zyra e Patentave regjistron dorëheqjen dhe bën publikimin përkatës sa më parë që të jetë e mundur.

Dorëheqja hyn në fuqi që nga data që Zyra e Patentave merr deklaratën e sipërpërmendur.

Zhvlerësimi

(1) Gjykata ka të drejtë, që me kërkesën e një personi, të marrë vendim për zhvlerësimin e një patente tërësisht ose pjesërisht për një nga arsyet e mëposhtme :

(a) kur subjekti i patentës, në përputhje me kërkesat e neneve 4(1), 5, 6 dhe 7 të këtij ligji, nuk është i patentueshëm;

(b) kur në përshkrimin e patentës, thelbi i shpikjes nuk parashtrohet në mënyrë të qartë dhe të plotë, për t'i dhënë mundësi çdo specialisti të asaj fushe të vërë shpikjen në zbatim (neni 14 (1) i këtij ligji);

(c) kur subjekti i patentës e kapërcen fushën e shpikjes së parashtruar në kërkesën për patentë të depozituar në formën e saj origjinale (neni 45 i këtij ligji) ;

(2) Gjykata ka të drejtë, t'i kërkojë pronarit të patentës, t'i paraqesë asaj për qëllime shqyrtimi botime dhe dokumente të tjera, që tregojnë për arritjet e mëparshme të cilave ai u është referuar ose në kuadrin e kërkesave për patentë, ose në forma të tjera mbrojtjeje të depozituara për të njëjtën ose thelbësisht të njëjtën shpikje prej vetë pronarit të patentës pranë ndonjë zyrë tjetër patentash kombëtare ose rajonale, ose gjithashtu, që kanë të bëjnë me procedurat që lidhen me patentën ose me forma të tjera mbrojtjeje, për kërkesën e patentës në fjalë.

Efektet e zhvlerësimit

(1) Çdo patentë, pretendim ose pjesë e pretendimit që zhvlerësohet, do të konsiderohet si e paqenë dhe e pavlerë, që nga data e lëshimit të patentës.

(2) Kur gjykata merr vendim për të zhvlerësuar një patentë tërësisht ose pjesërisht, ajo duhet të njoftojë Zyrën e Patentave, e cila bën regjistrimin e këtij vendimi dhe e publikon atë sa më parë që të jetë e mundur.

K R U E X

KËRKESAT NDËRKOMBËTARE SIPAS TRAKTATIT TË BASHKËPUNIMIT NË FUSHËN E PATENTAVE

Kërkesë sipas traktatit të bashkëpunimit në fushën e patentave

(1) Me termin “kërkesë ndërkombëtare” që përdoret në këtë kapitull dhe në kapitullin XI të këtij ligji, nënkuptohet një kërkesë për patentë e depozituar në përputhje me Traktatin e Bashkëpunimit në Fushën e Patentave (që këtu e në vijim “PCT”).

(2) Kur ky ligj i referohet PCT, kjo referencë përfshin edhe Rregulloren e PCT.

(3) Në Republikën e Shqipërisë, çdo kërkesë ndërkombëtare që përcakton Republikën e Shqipërisë, është e njëvlershme me një kërkesë të depozituar në Zyrën e Patentave në përputhje me nenin 13 të këtij ligji. Një kërkesë e tillë ndërkombëtare ka efektin e një kërkesë të rregullt kombëtare ashtu si edhe data e saj e depozitimit ndërkombëtar konsiderohet si data e depozitimit të kërkesës në Zyrën e Patentave. Zyra e Patentave vepron si një Zyrë” e përcaktuar” dhe “e zgjedhur”, në kuptimin që kanë këto terma në kuadrin e PCT.

(4) PCT dhe Rregullorja e PCT do të kenë efekt të plotë dhe do të zbatohen në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

(5) Në rast se dispozitat e PCT bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, atëhere për bazë do të merren dispozitat e PCT.

Zyrë e përcaktuar dhe Zyrë e zgjedhur

(1) Kur Republika e Shqipërisë është shënuar në kërkesën ndërkombëtare si një shtet “i

përcaktuar” ose si një shtet “i zgjedhur” dhe kur paraqitësi i kërkesës kërkon patentë të Republikës së Shqipërisë sipas kapitujve I deri IX të këtij ligji, ai duhet që brenda një muaji pas mbarimit të afateve të caktuara përkatësisht në nenet 22 dhe 39 të PCT, të dorëzojë pranë Zyrës së Patentave një përkthim në gjuhën shqipe të përshkrimit, pretendimeve, përmbledhjes së shpikjes dhe të specifikimeve të vizatimeve, nëqoftëse ka të tilla në kërkesën ndërkombëtare, si dhe të paguajë tarifën e caktuar pranë kësaj Zyre.

(2) Në rast se kërkesat e paragrafit (1) të këtij neni, në lidhje me dorëzimin e përkthimit në gjuhën shqipe të materialeve të kërkesës ndërkombëtare nuk plotësohen, atëhere kërkesa ndërkombëtare konsiderohet e tërhequr.

(3) Shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës ndërkombëtare në Zyrën e Patentave kryhet në përputhje me nenin 22 të këtij ligji.

(4) Kur Republika e Shqipërisë është shënuar në kërkesën ndërkombëtare si një shtet “i përcaktuar” ose “i zgjedhur”, dhe kur kjo kërkesë është publikuar sipas nenit 21 të PCT, atëhere kërkesa ndërkombëtare siguron po ato të drejta si edhe kërkesat e publikuara sipas nenit 21 të këtij ligji, duke filluar nga data kur një përkthim në gjuhën shqipe i pretendimeve të shpikjes publikohet prej Zyrës së Patentave. Ky përkthim duhet të publikohet brenda tre muajve nga data e paraqitjes së tij në Zyrën e Patentave prej paraqitësit të kërkesës ndërkombëtare.

Neni 50

Kërkesat ndërkombëtare të depozituara pranë Zyrës së Patentave kur kjo shërbën si Zyrë pranimi

(1) Në rast se paraqitësi i kërkesës është shtetas shqiptar ose me banim të përhershëm në Shqipëri, atëhere kërkesa ndërkombëtare, në pajtim me nenin 10 të PCT, mund të depozitohet pranë Zyrës së Patentave, e cila shërbën në këtë rast si Zyrë Pranimi.

(2) Në përputhje me rregullin 14 të Rregullores së PCT, paraqitësi i kërkesës duhet t’i paguajë Zyrës së Patentave tarifën përkatëse, brenda një muaji nga data e depozitimit të kërkesës ndërkombëtare.

(3) Kërkesat ndërkombëtare, që depozitohen pranë Zyrës së Patentave si një Zyrë pranimi, duhen përpiluar në gjuhën e përcaktuar prej marrëveshjes ndërmjet Byrosë Ndërkombëtare të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale dhe Autoriteteve Ndërkombëtare të Kërkimit të specifikuara prej Zyrës së Patentave, sipas rregullit 35 të Rregullores së PCT.

K R E U X I

REGJISTRIMI I PATENTAVE EVROPIANE

Neni 51

Shtrirja e Patentave Evropiane

Mbrojtja e shpikjeve në Republikën e Shqipërisë mund të sigurohet gjithashtu edhe me anën e shtrirjes së efekteve të kërkesave për patentë evropiane dhe të patentave evropiane, në përputhje me një Rregullore që do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit të Marrëveshjes përkatëse ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës Evropiane të Patentave.

K R E U X I I

PATENTUESHMËRIA E MODELEVE TË PËRDORIMIT

Neni 52

Kushtet e patentueshmërisë

(1) Një model përdorimi është i patentueshëm në qoftë se përbën novacion dhe është i zbatueshëm në industri.

(2) Mbrojtja me anën e modeleve të përdorimit sigurohet për modelet që bëjnë të mundur ritjen e efektivitetit ose lehtësimin e zbatimit apo të përdorimit të makinave, instrumentave, pajisjeve dhe objekteve të jetës së përditshme, nëpërmjet realizimit të formave, skemave, konfiguracioneve ose

kombinimeve elementësh të veçanta, duke përmbushur kërkesat e parashtruara në paragrafin (1) të këtij neni.

Një patentë e lëshuar për një makinë si një e tërë nuk përfshin mbrojtjen e pjesëve të makinës. Efektet e një modeli përdorimi shtrihen edhe tek modelet që kanë një përdorim të njëvlershëm, me kusht që ata të jenë bazuar mbi të njëjtin koncept novator.

(3) Nuk patentohen modelet e përdorimit për metodat dhe objektet që referohen në nenin 4(2)(3)(4) të këtij ligji.

Neni 53

Novacion dhe zbatueshmëri në industri

Për modelet e përdorimit, novacioni dhe zbatueshmëria në industri, përcaktohen në përputhje me klauzolat e neneve 5 dhe 7 të këtij ligji.

Neni 54

Mbrojtja ligjore

Mbrojtja ligjore për modelet e përdorimit sigurohet me anën e patentave për modele (shih Nenin 53) për një periudhë kohe prej 10 vjetësh, duke filluar nga data e depozitimit.

Neni 55

Shndërrimi

Mbi bazën e një lutjeje me shkrim prej paraqitësit të kërkesës, një kërkesë patentë për shpikje, mund të shndërrohet në një kërkesë patente për model përdorimi, për aq kohë sa, ndaj kërkesës për patentë për shpikjen, nuk është marrë ndonjë vendim.

Neni 56

Trajtimi i modeleve të përdorimit

Trajtimi i modeleve të përdorimit është i njëjlojtë me trajtimin e shpikjeve sipas këtij ligji, përveç rasteve kur në këtë kapitull nuk parashikohet ndryshe.

K R E U XIII

SHQYRTIMI I MOSMARRËVESHJEVE NË GJYKATË

Neni 57

Shqyrtimi i mosmarrëveshjeve në Gjykatë

(1) Gjykata e Rrethit të Tiranës ka juridiksion ekskluziv për çdo mosmarrëveshje që ka të bëjë me një kërkesë për patentë ose patentë dhe veçanërisht për :

(a) çdo veprim për shkelje ose një deklaratë të mosshkeljes ndaj një patentë ose kërkesë për patentë ;

(b) çdo veprim për zhvlerësimin e një patente;

(c) çdo veprim në lidhje me pronësinë ose transferimin e të drejtës së një kërkesë për patentë ose patentë;

(d) çdo veprim në lidhje me një kontratë licencë ;

(e) dhënien e licencave jovullnetare;

(f) shqyrtimin e vendimeve të Bordit të Apelimit të Zyrës së Patentave për të cilat parashikohet në këtë ligj.

(2) Kundër vendimit të gjykatës së Rrethit të Tiranës, të marrë për çdo lloj mosmarrëveshje të përmendur në paragrafin e mësipërm, mund të bëhet ankim në gjykatën e Apelit.

Neni 58

Afatet për ndërmarrjen e veprimeve në Gjykatë

(1) Veprime në Gjykatë mund të ndërmerren brenda gjithë periudhës së kohëzgjatjes së patentës, pa ndonjë afat kufitar, në rastet kur mosmarrëveshja ka lindur mbi bazën e :

(a) zhvlerësimi të patentës sipas nenit 47 të këtij ligji;

(b) dhënies së licencave.

(2) Për rastet e tjera të mosmarrëveshjeve, të cilat nuk përmenden në paragrafin e mësipërm, afati i fillimit të veprimeve në gjykatë është i kufizuar brenda tre vjetëve, përveç rasteve kur në këtë ligj ose në dispozita të tjera në fuqi janë parashikuar afate të tjera.

PJESA II

DIZENJOT INDUSTRIALE

K R E U XIV

PËRKUFIZIMI , KUSHTET DHE E DREJTA PËR MBROJTJE

Neni 59

Përkufizimi dhe kushtet e mbrojtjes

(1) Për qëllimet e këtij ligji, me termin “dizenjo industriale”(në vazhdim do të quhet “dizenjo”) kuptohen tiparet e formës së jashtme të një produkti, të cilat nuk janë të diktuar vetëm nga funksioni teknik i produktit dhe që i japin atij një paraqitje të veçantë. Dizenjot industriale mund të jenë dy përmasore, tre përmasore ose kombinime të tyre.

(2)(a) Për të siguruar mbrojtje, dizenjoja duhet të jetë e re dhe të jetë e përdorëshme në produktet industriale ose artizanale.

(b) Një dizenjo konsiderohet e re, në qoftë se nuk është e njëjtë ose shumë e ngjashme me një dizenjo, e cila nëpërmjet publikimit ose përdorimit publik është bërë e njohur për publikun kudo në botë, para datës së depozitimit, ose kur është kërkuar prioritet, para datës prioritare të kërkesës për regjistrimin e dizenjos së mëparshme.

(c) Nënparagrafi 2(b) i këtij neni nuk zbatohet kur krijuesi i dizenjos ose pasardhësi i ligjshëm i tij ka publikuar ose ka përdorur publikisht dizenjon brenda një periudhe 12 mujore para datës së depozitimit të kërkesës ose para datës prioritare, kur është kërkuar prioritet.

(3) Mbrojtja nuk jepet për një dizenjo, publikimi ose shfrytëzimi i të cilës bie në kundërshtim me rendin dhe moralin publik.

Neni 60

E drejta për mbrojtje

(1) E drejta ekskluzive për një dizenjo i përket krijuesit të dizenjos ose pasardhësve të tij të ligjshëm. Për rastin kur krijuesit janë të përbashkët, ata kanë të drejta të barabarta, përveç rasteve kur në një marrëveshje kanë rënë dakort ndryshe.

(2) Në qoftë se dy ose më shumë kërkesa janë regjistruar nga persona të ndryshëm në lidhje me të njëjtën dizenjo, dhe krijuesit e kanë krijuar këtë dizenjo në mënyrë të pavarur nga njëri tjetri, e drejta për mbrojtje për këtë dizenjo i përket paraqitësit të kërkesës, kërkesa e të cilit ka datë depozitimi me të hershme, ose kur pretendohet për prioritet, datë prioritare më të hershme, përsa kohë që kërkesa e tij nuk është tërhequr ose hedhur poshtë.

Neni 61

Dizenjo industriale e krijuar në zbatim të një porositë ose prej një të punësuar

(1) (a) Në rast se një dizenjo është krijuar në zbatim të një porositë apo nga një kontratë pune, e drejta për mbrojtje për këtë dizenjo i përket porositësit ose punëdhënësit, përveç rasteve kur në marrëveshje përcaktohet ndryshe.

(b) Kur dizenjoja ka një vlerë ekonomike shumë më të madhe se sa palët e kanë parashikuar

në kohën e përfundimit të kontratës, i punësuar ka të drejtën e një shpërblimi të veçantë. Në mungesë të një marrëveshjeje midis palëve, masa e shpërblimit përcaktohet nga gjykata.

(2) (a) Kur një punonjës kontrata e punës e të cilit nuk e detyron atë të merret me aktivitete krijuese krijon një dizeno duke përdorur të dhëna si dhe mjete të tjera, të cilat i janë bërë të njohura nëpërmjet punësimit të tij në fushën e aktivitetit të punëdhënësit të tij, e drejta për mbrojtje për këtë dizeno i takon punonjësit, përveç rasteve kur brenda një periudhe 4 muajore nga data në të cilën punëdhënësi i është paraqitur raporti i referuar në nënparagrafin (2)(b) të këtij neni ose nga data në të cilën punëdhënësi është njohur me dizenjon në mënyra të tjera, cilado qoftë data më e hershme, punëdhënësi njofton të punësuarin me anë të një deklarate me shkrim për interesin e tij për dizenjon.

(b) I punësuar, i cili ka krijuar një dizeno të llojit që i referohet nënparagrafit (2)(a) të këtij neni do t'i paraqesë menjëherë punëdhënësit një raport për dizenjon me anë të një deklarate me shkrim.

(c) Në qoftë se brenda periudhës së referuar në nënparagrafin (2)(a) të këtij neni, punëdhënësi bën një deklaratë ku shpreh interesin e tij për dizenjon, e drejta për mbrojtje për këtë dizeno i përket atij që nga fillimi. I punësuar ka të drejtën e një shpërblimi i cili varet nga paga e tij, nga vlera ekonomike e dizenjës si dhe nga përfitimi që punëdhënësi merr nga kjo dizeno. Në mungesë të një marrëveshjeje midis palëve, masa e shpërblimit përcaktohet nga Gjykata.

(3) Ndonjë kontratë, e cila është më pak e favorshme për krijuesin e dizenjës se sa parashikimet e këtij neni, konsiderohet si e paqënë.

Neni 62

Emri i krijësit të dizenjës

Çdo publikim i Zyrës së Patentave, që bën fjalë për një kërkesë ose regjistrim të një dizenjoje duhet të përmënte krijuesin ose krijësit e asaj dizenjoje përveç rasteve kur krijësi me anën e një deklarate të nënshkruar prej tij, dhe të depozituar në këtë Zyrë, kërkon që emri i tij të mos përmëndet.

KREU XV

KËRKESA PËR REGJISTRIM

Neni 63

Data e depozitimit

(1) Do të quhet datë e depozitimit të kërkesës për regjistrimin e dizenjës, data në të cilën Zyra e Patentave merr kërkesën, e cila përmban elementët e mëposhtëm:

(a) një kërkesë për regjistrimin e dizenjës;

(b) emrin dhe adresën e paraqitësit të kërkesës;

(c) një përshkrim të dizenjës;

(d) vizatime të pamjes së përgjithëshme të produktit ose të produkteve, një skemë të konfeksionit ose një model të produktit ose të produkteve, në qoftë se është e nevojshme për të qartësuar esencën e dizenjës industriale;

(e) një tregues të produktit ose të produkteve, në të cilat dizenjoja është parashikuar të përfshihet;

(f) kur pretendohet për prioritet në kërkesë, frazat e përdorura për këtë qëllim bashkë me identifikimin e Zyrës në të cilën kërkesa për të cilën pretendohet për prioritet (kërkesa prioritare) është depozituar, data e depozitimit të kërkesës prioritare (data prioritare) dhe në qoftë se është e mundur, numri i kërkesës prioritare;

(g) nënshkrimi i paraqitësit të kërkesës.

(h) një autorizim përfaqësimi, në qoftë se paraqitja e kërkesës bëhet nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar të patentave.

(2) Kërkesa duhet të identifikojë krijuesin ose krijësit e dizenjës.

(3) Dy ose më shumë dizeno mund të jenë subjekt i së njëjtës kërkesë, me kusht që ato të kenë të njëjtën klasë të Klasifikimit Ndërkombëtar të vendosur nga Marrëveshja e Lokarnos.

(4) Çdo kërkesë shoqërohet nga pagesa e tarifës së caktuar.

(5) Paraqitja e kërkesës për regjistrimin e dizenjës dhe të gjithë procedurat e mëtejshme që lidhen me të (korrespondenca) bëhen sipas rregullave të përcaktuara në Rregulloren e Zyrës së

Patentave.

(6) E drejta për prioritet njihet për vendet anëtare të Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronës Industriale.

Neni 64

Mbrojtja e përkohshme e dizenjove industriale të ekspozuar në ekspozitat ndërkombëtare

(1) Për regjistrimin e një dizenjoje, paraqitësi i kërkesës, i cili ka ekspozuar në një ekspozitë zyrtare ndërkombëtare një produkt ose produkte me këtë dizenjo, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për regjistrimin e kësaj dizenjoje brenda gjashtë muajve nga dita në të cilën produkti ose produktet e ofruara me këtë dizenjo janë paraqitur për herë të parë në këtë ekspozitë. Kjo datë përfaqëson edhe datën e depozitimit të kërkesës për regjistrimin e dizenjës.

(2) Si provë për ekspozimin e produktit ose të produkteve që paraqiten me këtë dizenjo, shërben një certifikatë e lëshuar nga autoritetet kompetentë të ekspozitës, e cila duhet të përmbajë edhe datën në të cilën dizenjoja u ekspozua për herë të parë, lidhur me produktin ose produktet e paraqitura në ekspozitë.

Neni 65

Shqyrtimi i formaliteteve

(1) Brenda tre muajve nga data e marrjes së kërkesës për regjistrimin e dizenjës, Zyra e Patentave kryen një shqyrtim paraprak të kërkesës, në mënyrë që ajo të jetë në përputhje me kërkesat e nenit 64 të këtij ligji dhe në përputhje me procedurën e vendosur, si dhe përcakton datën e depozitimit të kërkesës ose datën prioritare të depozitimit, në rastin kur paraqitësi i kërkesës ka të drejtën për prioritet.

(2) Në qoftë se Zyra e Patentave konstaton se nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat e nenit 64 të këtij ligji, ajo i drejtohet paraqitësit të kërkesës të bëjë plotësimin e tyre brenda tre muajve nga dita e kërimit, dhe në qoftë se paraqitësi i kërkesës nuk bën plotësimet e kërkuara, Zyra e Patentave refuzon kërkesën dhe njofton për këtë, me shkrim, paraqitësin e kërkesës.

(3) Brenda një periudhe prej tre muajsh nga data e marrjes së njoftimit për refuzimin e kërkesës, paraqitësi i kërkesës, ka të drejtën, kundrejt një pagese, të dorëzojë një kërkesë për apelim në Bordin e Apelit të Zyrës së Patentave.

(4) Vendimi i Bordit të Apelit të Zyrës së Patentave në lidhje me paragrafin (3) të këtij neni është i formës së prerë.

Neni 66

Regjistrimi i dizenjës. Shtyrja e afatit të publikimit

(1) Zyra e Patentave shqyrton kërkesën e depozituar nëse ajo përputhet me kërkesat e nenit 60(3) të këtij ligji dhe brenda një periudhe të caktuar, në përputhje me rezultatet e shqyrtimit, miraton vendimin për regjistrimin e dizenjës ose për refuzimin e saj. Paraqitësi i kërkesës njoftohet për vendimin me shkrim, dhe në qoftë se vendimi është pozitiv njoftohet për të paguar tarifën e regjistrimit të dizenjës.

(2) Menjëherë pas vendimit për të regjistruar dizenjën ose dizenjot, Zyra e Patentave bën publikimin e tyre sipas mënyrës së përcaktuar.

(3) Brenda një periudhe 2 mujore nga data e marrjes së njoftimit për refuzimin e regjistrimit, paraqitësi i kërkesës ka të drejtën, kundrejt një pagese të caktuar, të dorëzojë një kërkesë për apelim në Bordin e Apelit të Zyrës së Patentave. Vendimi i Bordit të Apelit lidhur me këtë paragraf mund të apelohe në Gjykatë brenda 6 muajve.

(4) Bashkë me depozitimin e kërkesës mund të jetë bërë një kërkesë për shtyrjen e publikimit të dizenjës ose të dizenjove të regjistruar, për një periudhë deri në 12 muaj pas datës së depozitimit të kërkesës. Në rastin e një kërkesë të tillë, Zyra e Patentave publikon informacion në lidhje me pronarin e dizenjës së regjistruar. Mbas mbarimit të periudhës së shtyrjes, bëhet publikimi i dizenjës së regjistruar, përveç rasteve kur kërkesa e depozituar është tërhequr para mbarimit të periudhës së përmendur më lart.

K R E U XVI
EFEKTET E REGJISTRIMIT

Neni 67

Të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi

(1) Pronari i dizenjës së regjistruar ka të drejtën të parandalojë palët e treta, nga prodhimi, importimi, furnizimi, shpërndarja ose mbajtja në pronësi për këto qëllime, të produkteve që përfshihen në dizenjon ose të produkteve të ngjashme me to, kur veprime të tilla janë ndërmarrë për qëllime tregtare.

(2) Paragrafi (1) i këtij neni nuk zbatohet në qoftë se produktet për të cilat bën fjalë ai paragraf, kanë qënë hedhur në treg, në Shqipëri ose në një territor tjetër të përcaktuar në marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe të Republikës së Shqipërisë.

(3) Të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi nuk do të shtrihen në pajisjet e anijeve, avionëve dhe të ndonjë automjeti tjetër që nuk është regjistruar në Republikën e Shqipërisë, kur këto hyjnë në mënyrë të përkohshme në territorin e Shqipërisë, po ashtu edhe importimi i pjesëve të këmbimit dhe pajisjeve për qëllim riparimi të automjeteve të tilla dhe kryerjeve të riparimeve të automjeteve.

Neni 68

Koha e regjistrimit dhe përtëritja

(1) Regjistrimi i dizenjës bëhet për 5 vjet, e llogaritur nga data e depozitimit të saj.

(2) Regjistrimi mund të përtërihet, kundrejt një pagese të caktuar, për periudha shtese prej pesë vjetësh deri në një afat të përgjithshëm prej 15 vjetësh nga data e depozitimit të dizenjës.

K R E U XVII
KONTRATAT E LICENCEVE

Neni 69

Kontratë licence

(1) Me termin “kontratë licence” në këtë ligj kuptohet çdo kontratë, me anën e së cilës pronari i regjistrimit të dizenjës (licencori) i jep të drejtën palës tjetër (të licencuarit) për të kryer cilindo prej veprimeve të përmendura në nenin 69(1) të këtij ligji.

(2) Kontrata e licencës duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të nënshkruhet nga palët në kontratë. Në rast të kundërt ajo nuk do të jetë e vlefshme.

(3) Kontrata e licencës duhet të regjistrohet në Zyrën e Patentave, në Regjistrin e dizenjave, kundrejt pagesës së tarifës së caktuar. I licencuari ka të drejtë t’i drejtohet Gjykatës lidhur me kontratën e licencës, vetëm pasi ajo të jetë regjistruar në regjistrin e dizenjës.

K R E U XVIII
SHKELJET

Neni 70

Procedurat për shkeljet

(1) Pronari i regjistrimit të dizenjës ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës e cila hap proces gjyqësor kundër personave që kanë kryer ose janë duke kryer shkeljen e të drejtave që përmenden në nenin 68 të këtij ligji. Mbajtësi i regjistrimit ka po ato të drejta edhe kundër personave që kanë kryer apo janë duke kryer veprime, të cilat çojnë në shkelje të të drejtave të përcaktuara në këtë ligj (shkelje eminente).

(2)(a) Në qoftë se mbajtësi i regjistrimit provon se është kryer ose është duke u kryer një shkelje e të drejtave të tij, ai ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës e cila urdhëron dëmshpërblimin. Në këtë dëmshpërblim përfshihen fitimi që ka siguruar personi që ka kryer shkeljen, dëmi që ka pësuar pronari

i dizenjos përveç atij që është përfshirë në fitimin e shkelësit si dhe shpenzimet duke përfshirë edhe taksën e gjyqit. Gjykata merr gjithashtu çdo masë që parashikohet në legjislacionin e vendit për të parandaluar shkeljet e mëtejshme.

(b) Në qoftë se mbajtësi i regjistrimit të dizenjos, provon se veprime të caktuara çojnë në shkelje eminente, ai ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës, e cila merr masa për të parandaluar këto shkelje dhe bën kompensime të tjera që parashikohen në legjislacionin e vendit.

K R E U XIX DORËHEQJA DHE ZHVLERËSIMI

Neni 71

Dorëheqja

(1) Mbajtësi i regjistrimit të një dizenjoje mund të heqë dorë nga regjistrimi me anë të një deklarate me shkrim, që i paraqitet Zyrës së Patentave. Dorëheqja hyn në fuqi nga data e marrjes së deklaratës nga Zyra. Në rastin kur regjistrimi është bërë për disa dizenjo të ndara, dorëheqja mund të bëhet për të gjitha ose për disa dizenjo të regjistruara.

(2) Zyra e Patentave e regjistron dorëheqjen në Regjistrin e dizenjove dhe bën publikimin e saj.

Neni 72

Zhvlerësimi

(1) Gjykata, me kërkesën e një personi, mund të zhvlerësojë një regjistrim për shkak se dizenjoja e regjistruar nuk plotëson kushtet për të qënë e mbrojtur në përputhje me nenin 60 të këtij Ligji.

(2) Çdo regjistrim që zhvlerësohet do të jetë i pavlefshëm që nga data e regjistrimit.

(3) Kur vendimi i gjykatës për të zhvlerësuar regjistrimin bëhet i formës së prerë, gjykata njofton Zyrën e Patentave. Zyra e Patentave bën regjistrimin e vendimit gjyqësor në Regjistrin e dizenjove dhe bën publikimin e saj.

PJESA III MARKAT TREGTARE DHE TË SHËRBIMIT

K R E U XX KUSHTET E MBROJTJES DHE E DREJTA PËR MBROJTJE

Neni 73

Elementët përbërës të markës

(1) Çdo shenjë ose kombinim i shenjave, që dallon mallrat ose shërbimet e një personi juridik ose të një personi fizik nga ato të një personi tjetër juridik ose fizik dhe që paraqitet në mënyrë grafike, mund të shërbejë si markë për mallrat ose markë për shërbimet (në vazhdim do të quhet “markë”).

(2) Marka kolektive është një markë që regjistrohet nga një kooperim tregtar ose industrial, nga një shoqatë ose organizim i ngjashëm i ndërmarrjeve të ndryshme, e cila përdoret për të dalluar mallrat dhe shërbimet e kësaj shoqate. Çdo ndërmarrje e shoqatës mundet gjithashtu, të ketë njëkohësisht edhe markat e veta. Në nene të veçanta të këtij ligji janë përshkruar dispozita mbi markat kolektive, por në raste të tjera dispozitat e dhëna për markat tregtare, zbatohen gjithashtu edhe për markat kolektive.

(3) Përbëjnë markë shenjat e mëposhtme :

(a) fjalë, duke përfshirë edhe emrat personalë, gërma, numra, shkurtime;

(b) shenja figurative, duke përfshirë shenjat e aparateve, format e mallrave ose ambalazhet e tyre;

(c) kombinime të ngjyrave ose nuancave të tyre;

(d) çdo kombinim i shenjave, që përmenden në pikat (a) deri (c) të këtij neni.

(4) Lloje të veçanta të markave të tilla si sinjalet e zërit dhe të dritës ose shenja të tjera regjistrohen në qoftë se ato paraqiten grafikisht.

Neni 74

Markat e paregjistrueshme

- (1) Një markë nuk mund të regjistrohet si markë tregtare në qoftë se :
- (a) nuk ka karakter dallues;
 - (b) përbëhet ekskluzivisht nga shenja ose tregues të cilët shërbejnë në treg për të treguar llojin, cilësinë, sasinë, qëllimin, vlerën, origjinën gjeografike ose kohën e prodhimit të mallrave ose të kryerjes së shërbimeve, ose karakteristika të tjera të mallrave ose shërbimeve;
 - (c) përbëhet ekskluzivisht nga shenja ose tregues të cilët janë bërë të zakonshëm në gjuhën e përditshme ose janë kthyer në praktika fikse në tregti;
 - (d) përbëhet nga forma ose linja të imponuara nga vetë natyra e mallrave ose shërbimeve ose nga forma ose linja që janë të nevojshme për të arritur një rezultat teknik;
 - (e) përbëhet nga shenja që mbrohen nga ligji mbi të Drejtën e Autorit, me përjashtim të rastit kur për këtë jepet autorizim nga vetë autori.
- (2) (a) Karakteri dallues i një shenje do të vlerësohet në lidhje të ngushtë me mallrat dhe shërbimet të cilat kjo shenjë ka për qëllim të dallojë.
- (b) Karakteri dallues fitohet në procesin e përdorimit.

Neni 75

Mosshkelja e interesave publike

- (1) Një shenjë nuk mbrohet si markë ose element i markës, në qoftë se mbrojtja e saj shkel interesat publike.
- (2) Në mënyrë të veçantë nuk mbrohen si markë ose elemente të markës:
- (a) - emrat e shteteve (të plota ose të shkurtuara) ;
 - emblemat shtetërore;
 - shenjat zyrtare të miratuara të tilla nga shteti;
 - shkurtimet dhe emblemat e organizatave ndërkombëtare;
 - simbolet fetare;
 - (b) emrat, portretet, pseudonimet e personave të mirënjohur nga publiku në qoftë se nuk autorizohen nga vetë personi ose pasardhësi i tij, përveç rasteve kur personat e sipërpërmendur kanë vdekur para më shumë se 50 vjetësh;
 - (c) shenja që bien në kundërshtim me rendin dhe moralin publik;
 - (d) shenja që prirura për të ç'orientuar publikun, në mënyrë të veçantë përsa i përket natyrës, cilësisë ose origjinës gjeografike të mallrave ose shërbimeve që ato kanë për qëllim të dallojnë.
- (3) Shenjat që i referohen nënparagrafit (2)(a) të këtij neni mund të përfshihen si elementë të pambrojtur të markës vetëm në rastin kur përdorimi i tyre lejohet nga autoritetet kompetentë.

Neni 76

Konflikti me të drejtat e mëparëshme

- (1) Një shenjë nuk mbrohet si markë, në qoftë se, përdorimi i saj si markë bie në kundërshtim me të drejtat e mëparëshme.
- (2) Në mënyrë të veçantë si të drejta të mëparëshme konsiderohen:
- (a) një markë identike ose e ngjashme e një pale të tretë, në lidhje me mallra ose shërbime identike ose të ngjashme, ose në bazë të kushteve të parashtruara nga neni 84(1)(b), në lidhje me mallra ose shërbime, të cilat nuk janë as identike as të ngjashme, por të cilat kanë një datë depozitimi ose datë prioritare më të herëshme dhe që janë regjistruar ose do të regjistrohen me vonë;
 - (b) një markë e mirënjohur në bazë të kuptimit që i jepet nga neni 6 bis i Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronës Industriale, e një pale të tretë.

Neni 77
E drejta për mbrojtje

- (1) E drejta ekskluzive për markë sipas këtij ligji, fitohet kur bëhet regjistrimi nga Zyra e Patentave.
- (2) E drejta ekskluzive për markë mund të fitohet edhe me pronësi të përbashkët.

K R E U XXI
PROCEDURA PËR REGJISTRIM

Neni 78
Data e depozitimit

(1) Datë e depozitimit të kërkesës për regjistrimin e markës, quhet data në të cilën Zyra e Patentave merr kërkesën, e cila duhet të përmbajë elementët e mëposhtëm :

- (a) një kërkesë për regjistrimin e markës;
 - (b) emrin dhe adresën e paraqitësit të kërkesës;
 - (c) përfaqësimin e markës;
 - (d) emrat e mallrave dhe shërbimeve për të cilët kërkohet regjistrimi i markës, të grupuara në bazë të Klasifikimit Ndërkombëtar për Mallrat dhe Shërbimet, duke përdorur aty ku është e mundur edhe Listën Alfabetike të Mallrave dhe Shërbimeve që është hartuar në përputhje me klasifikimin e sipërpërmendur;
 - (e) deklaratën në të cilën pretendohet për prioritet, identifikimin e Zyrës së Patentave pranë së cilës është depozituar kërkesa prioritare, datën prioritare dhe nëse është e mundur edhe numrin që mban kërkesa prioritare, në ato raste kur në një kërkesë paraqitet pretendimi për prioritet;
 - (f) nënshkrimin e paraqitësit të kërkesës;
 - (g) një autorizim përfaqësimi në qoftë se kërkesa paraqitet nëpërmjet një përfaqësuesi të autorizuar të patentave.
- (2) Paraqitja e kërkesës për regjistrimin e markës si dhe të gjitha procedurat në lidhje me të (korrespondenca) bëhen sipas kushteve të përcaktuara në Rregulloren e Zyrës së Patentave.
- (3) Në rastet e markave kolektive, në Zyrën e Patentave dorëzohen Rregullat e përdorimit të markës kolektive, të cilat konfirmohen nga autoritetet ekzekutive të markës kolektive ose nga një person i autorizuar nga autoritetet ekzekutive. Rregullat tregojnë përdoruesit e markës, dispozitat për përdorimin e markës dhe informacion mbi kontrollin e përdorimit të markës. Pronari i markës kolektive duhet të njoftojë Zyrën e Patentave për të gjitha ndryshimet që mund të bëhen më vonë në këto Rregulla.
- (4) Asnjë datë depozitimi e kërkesës për regjistrimin e markave tregëtare ose të shërbimit nuk do të akordohet derisa të mos jetë paguar tarifa e caktuar.
- (5) E drejta për prioritet njihet për vendet anëtare të Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronës Industriale .

Neni 79
Mbrojtja e përkohëshme e markave të ekspozuara në ekspozitat ndërkombëtare

- (1) Për regjistrimin e një marke, paraqitësi i kërkesës, i cili ka ekspozuar në një ekspozitë zyrtare ndërkombëtare mallra që mbajnë këtë markë ose shërbime që kryhen nën këtë markë, ka të drejtën të paraqesë kërkesë për regjistrimin e kësaj marke brenda 6 muajve nga dita në të cilën mallrat ose shërbimet e ofruara nën këtë markë janë ekspozuar për herë të parë në këtë ekspozitë. Kjo datë do të përfaqësojë dhe datën e depozitimit të kërkesës për regjistrimin e markës tregëtare ose të shërbimit.
- (2) Si provë për ekspozimin e mallrave apo shërbimeve që do të paraqiten nën këtë markë, shërben një certifikatë e lëshuar nga autoritetet kompetente të ekspozitës, e cila duhet të përmbajë edhe datën në të cilën marka u ekspozua për herë të parë, lidhur me mallrat apo shërbimet që u paraqitën në ekspozitë.

Neni 80
Ndarja e kërkesës fillestare

Çdo kërkesë që i referohet mallrave ose shërbimeve të ndryshme(kërkesa fillestare) mund të ndahet nga paraqitësi i kërkesës në dy ose më shumë kërkesa më vhtë duke shpërndarë nëpër këto të fundit mallrat ose shërbimet që i referohen kërkesës fillestare dhe që i takojnë një klase të Klasifikimit Ndërkombëtar të Mallrave dhe Shërbimeve. Kërkesat e ndara do të kenë datën e depozitimit të kërkesës fillestare,dhe përfitojnë të drejtën për prioritet, nëse ka. Çdo kërkesë e ndarë shoqërohet nga pagesa e tarifës së përcaktuar.

Neni 81
Shqyrtimi i formaliteteve

(1) Brenda 3 muajve pas marrjes se kërkesës për regjistrimin e markës tregtare ose të shërbimit, Zyra e Patentave do të kryejë një shqyrtim paraprak të kërkesës, në mënyrë që ajo të jetë në përputhje me kërkesat e nenit 79 të këtij ligji dhe në përputhje me procedurën e vendosur, si dhe përcakton datën e depozitimit të kërkesës ose datën prioritare të depozitimit, në rastin kur paraqitësi i kërkesës ka të drejtën për prioritet.

(2) Në qoftë se Zyra e Patentave konstaton se nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat e nenit 79 të këtij ligji, atëhere ajo i drejtohet paraqitësit të kërkesës të bëjë plotësimin e tyre brenda 3 muajve dhe në qoftë se paraqitësi i kërkesës nuk bën plotësimet e kërkuara, Zyra e Patentave e refuzon kërkesën dhe njofton për këtë me shkrim paraqitësin e kërkesës.

(3) Brenda një periudhe prej 3 muajsh nga data e marrjes së njoftimit për mospranimin e kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka të drejtën, kundrejt një pagese, të dorëzojë një kërkesë për apelim në Bordin e Apelimit të Zyrës se Patentave.Vendimi i Bordit të Apelimit të Zyrës se Patentave në lidhje me këtë paragraf është i formës së prerë.

(4) Në qoftë se kërkesa plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 79 të këtij ligji, Zyra e Patentave njofton me shkrim paraqitësin e kërkesës, lidhur me pranimin për shqyrtim të kërkesës dhe bën publikimin e saj.

Neni 82
Regjistrimi i markës

(1) Zyra e Patentave shqyrton kërkesën e depozituar nëse ajo përputhet me kërkesat e nenit 74(3)(4), dhe nenit 76(2)(a)(b) dhe (c) të këtij ligji.

(2) Gjatë shqyrtimit, Zyra e Patentave ka të drejtë të kërkojë nga paraqitësi i kërkesës materiale dhe dokumenta shtesë të nevojshme për shqyrtimin, duke përcaktuar dhe kohën për dorëzimin e tyre.

(3) Brenda një periudhe 5 mujore nga data e depozitimit të kërkesës, Zyra e Patentave, në përputhje me rezultatet e shqyrtimit miraton vendimin për regjistrimin e markës ose për refuzimin e regjistrimit dhe bën publikimin e saj. Paraqitësi i kërkesës njoftohet për vendimin me shkrim dhe, në qoftë se vendimi është pozitiv njoftohet për të paguar tarifën e regjistrimit dhe të publikimit të markës.

(4) Brenda një periudhe 2 mujore nga data e marrjes së njoftimit për refuzimin e regjistrimit, paraqitësi i kërkesës ka të drejtën, kundrejt një pagese të caktuar, të depozitojë një kërkesë për apelim në Bordin e Apelimit të Zyrës së Patentave.

(5) Vendimi i Bordit të Apelimit të Zyrës së Patentave në lidhje me paragrafin e mësipërm, mund të apelohe në Gjykatë brenda 6 muajve.

K R E U XXII
EFEKTET E REGJISTRIMIT TË MARKËS

Neni 83
Të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi

(1)(a) Pronari i markës së regjistruar ka të drejtën të pengojë palët e treta të përdorin pa autorizimin e tij në kursin e tregut, si markë ose si emër tregëtar, një shenjë identike ose të ngjashme për mallrat ose shërbimet, të cilat janë identike ose të ngjashme me ato për të cilat është regjistruar marka, kur ky përdorim mund të çojë në ç'orientimin e publikut. Kur përdorimi lidhet me një shenjë identike për mallra ose shërbime identike, mundësia për konfuzion merret si e mirëqenë.

(b) Pronari i markës së regjistruar ka të drejtën të pengojë palët e treta të përdorin pa autorizimin e tij në kursin e tregut, si markë ose si emër tregëtar, një shenjë identike ose të ngjashme për mallrat ose shërbimet, të cilat nuk janë as identike dhe as të ngjashme me ato për të cilat është regjistruar marka, kur marka është e mirënjohur dhe përdorimi i saj është i dëmshëm për karakterin dallues dhe reputacionin e markës.

(2) Pavarësisht nga paragrafi (1) i këtij neni, pronari i markës nuk ka të drejtën që përmendet në atë paragraf lidhur me mallrat të cilat janë hedhur nga pronari vetë ose me lejen e tij, në tregun e Republikës së Shqipërisë ose në ndonjë territor që përcaktohet në marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe të Republikës së Shqipërisë, në qoftë se nuk plotëson kushtin që, as mallrat dhe as mënyra e përdorimit të markës nuk do të ndryshohen.

(3) Pronari i markës së regjistruar nuk ka të drejtën të ndalojë palët e treta nga përdorimi korrekt i emrit, adresës, pseudonimit të tij, ose një tregues të saktë lidhur me llojin, cilësinë, sasinë, destinacionin, vlerën, vendin e origjinës ose kohën e prodhimit të mallrave ose të kryerjes së shërbimeve, për sa kohë që një përdorim i tillë i përmbahet qëllimeve të demonstrimit apo informacionit të mirëfilltë dhe nuk ç'orienton publikun lidhur me burimin e mallrave ose shërbimeve.

(4) Çdo person ose ndërmarrje mund të zotërojë një ose më shumë marka.

(5) E drejta ekskluzive për markë do të vertëtohet nëpërmjet certifikatës së regjistrimit të lëshuar nga Zyra e Patentave.

Neni 84

Ndryshimet në emra ose adresa

Në rastin kur nuk ka ndryshim në person të pronarit të markës së regjistruar, por ka ndryshim në emrin ose adresën e tij, atëhere kërkesa për shënimin e ndryshimit në regjistrin e markave të Zyrës së Patentave bëhet në formën e një komunikimi ndaj kësaj Zyrë të nënshkruar nga pronari i markës së regjistruar ose përfaqësuesi i tij, duke treguar numrin e regjistrimit për të cilin bëhet fjalë dhe ndryshimin që do të shënohet.

Neni 85

Ndryshimi në pronësi

Në rastin kur ka ndryshim në vetë personin e pronarit të markës së regjistruar, kërkesa për shënimin e ndryshimit nga Zyra në regjistrin e saj të markave bëhet në formën e një komunikimi të nënshkruar nga pronari i markës së regjistruar ose përfaqësuesi i tij ose nga personi i cili fiton pronësinë (pronari i ri) ose përfaqësuesi i tij, duke treguar në këtë komunikim numrin e regjistrimit për të cilin bëhet fjalë dhe ndryshimin që do të shënohet.

Neni 86

Kohëzgjatja e regjistrimit dhe përtëritja e tij

(1) Regjistrimi i markës tregtare dhe të shërbimit bëhet për 10 vjet, duke filluar nga data e depozitimit të saj.

(2) Një kërkesë për përtëritjen e regjistrimit duhet të përmbajë treguesit ose elementët e mëposhtëm :

- (a) një kërkesë për përtëritjen e regjistrimit ;
- (b) emrin dhe adresën e pronarit të markës së regjistruar;
- (c) datën dhe numrin e regjistrimit për të cilin bëhet fjalë;
- (d) emrin dhe adresën e përfaqësuesit të paraqitësit të kërkesës, në qoftë se ka përfaqësues;
- (e) emrat e mallrave ose të shërbimeve për të cilat është kërkuar përtëritja e regjistrimit, të grupuara sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Mallrave dhe të Shërbimeve, duke përdorur aty ku është

e mundur Listën Alfabetike të Mallrave dhe Shërbimeve që është hartuar në përputhje me klasifikimin e sipërpërmendur;

(f) një nënshkrim nga pronari i markës së regjistruar ose përfaqësuesi i tij, në qoftë se ka përfaqësues.

(3) Përtëritja e regjistrimit mund të bëhet në çdo 10 vjet kundrejt pagesës së tarifës së caktuar.

K R E U XXIII KONTRATAT E LICENCE

Neni 87

Kontratë licence

(1) Në kontekstin e këtij ligji, me “Kontratë Licence” kuptohet çdo kontratë, me anën e të cilës, pronari i një marke të regjistruar (“licencori”) i jep palës tjetër (“të licencuarit”) miratimin, që kjo palë të kryejë në vendin e tij çdo njërin nga aktet që përmenden në nenin 85 të këtij ligji, përsa i përket markës së regjistruar.

(2) Kontrata e licencës duhet të bëhet me shkrim dhe të nënshkruhet nga palët në kontratë, përndryshe kontrata nuk do të jetë e vlefshme.

(3) Kontrata e licencës e përfunduar, duhet të shënohet në regjistrin e markave kundrejt pagesës së tarifës së caktuar. I licencuari ka të drejtë t’i drejtohet Gjykatës, lidhur me kontratën e licencës, vetëm në rast se ajo është regjistruar në regjistrin e markave.

Neni 88

Pavlefshmëria e kontratave të licencave

Kontrata e licencës nuk është e vlefshme, në rastin kur ajo nuk përmban detyrimet që licencori i vë të licencuarit për të siguruar kontrollin efektiv të cilësisë së mallrave apo të shërbimeve, për të cilat përdoret marka e regjistruar.

K R E U XXIV SHKELJET

Neni 89

Procedurat për shkelje

(1) Pronari i markës së regjistruar ka të drejtë t’i drejtohet Gjykatës, e cila hap proces gjyqësor kundër personave që kanë shkelur ose janë duke shkelur të drejtat e mbajtësit të regjistrimit të markës, që përmenden në nenin 84 të këtij ligji. Pronari ka po ato të drejta edhe kundër personave që kanë kryer ose janë duke kryer veprime, të cilat çojnë në shkelje të të drejtave të tij (“shkelje eminente”).

(2) (a) Në rast se pronari i markës së regjistruar provon se është kryer apo është duke u kryer një shkelje e të drejtave të tij, ai ka të drejtë t’i drejtohet Gjykatës, e cila do të urdhërojë dëmshpërblimin e tij. Në këtë dëmshpërblim përfshihen fitimi që ka siguruar personi që ka kryer shkeljen, dëmi që ka pësuar pronari i markës përveç atij që është përfshirë në fitimin e shkelësit si dhe shpenzimet, duke përfshirë edhe taksën e gjyqit. Gjykata merr gjithashtu çdo masë që parashikohet në legjislacionin e vendit për të parandaluar shkeljet e mëtejshme.

(b) Në rastin kur pronari i markës së regjistruar, provon se veprime të caktuara çojnë në shkelje eminente, ai ka të drejtë t’i drejtohet Gjykatës, e cila merr masa për të parandaluar këto shkelje dhe bën kompensime të tjera që parashikohen në legjislacionin e vendit.

K R E U XXV DORËHEQJA, ZHVLERËSIMI, SHFUQIZIMI

Neni 90
Dorëheqja

(1) Pronari i markës së regjistruar, mund të heqë dorë nga regjistrimi me anë të një deklarate me shkrim që paraqitet pranë Zyrës së Patentave. Dorëheqja hyn në fuqi nga data kur Zyra e Patentave merr deklaratën me shkrim. Dorëheqja mund të bëhet për disa ose për të gjithë mallrat dhe shërbimet për të cilat është bërë regjistrimi i markës.

(2) Zyra e Patentave regjistron dorëheqjen në Regjistrin e markave dhe e publikon atë.

Neni 91
Zhvlerësimi

(1) Gjykata ka të drejtë që, me kërkesë të një personi të zhvlerësojë një regjistrim në rastin kur regjistrimi në fjalë nuk i përmbush kërkesat e nenit 74(3), 75, 76 dhe nenit 77 të këtij ligji.

(2) Çdo regjistrim i zhvlerësuar konsiderohet si i paqënë që nga data e regjistrimit.

(3) Kur vendimi i Gjykatës për të zhvlerësuar një regjistrim bëhet i formës së prerë, Gjykata njofton për këtë Zyrën e Patentave. Zyra e Patentave regjistron vendimin në regjistrin e markave dhe e publikon atë.

Neni 92
Shfuqizimi

(1) Regjistrimi i një marke do të shfuqizohet në qoftë se :

(a) pronari i markës së regjistruar nuk e ka përdorur markën e regjistruar në lidhje me mallrat dhe shërbimet e përmendura në regjistrim për një periudhë 5-vjeçare, pa pasur arsye bindëse.

(2) Kërkesa për shfuqizimin e markës lidhur me nënparagrafin 1(a) të këtij neni bëhet nga palët e interesuara në Gjykatë. Gjykata njofton Zyrën e Patentave lidhur me vendimin e saj brenda një muaji nga data e marrjes së vendimit.

(3) Një regjistrim, në bazë të paragrafit (1)(a) të këtij neni, nuk mund të shfuqizohet në rastet e mëposhtme të përdorimit të markës së regjistruar, lidhur me mallrat apo shërbimet e përmendura në regjistrim :

(a) kur marka është përdorur në kuadrin e një kontrate për licencë, të regjistruar në regjistrin e markave;

(b) kur marka është përdorur në formë të modifikuar, pa ndryshuar karakterin e saj dallues;

(c) kur vendosja e markës mbi mallra apo amballazhin e tyre bëhet ekskluzivisht për qëllime transporti;

(d) kur marka është përdorur për publicitet dhe korrespondencë biznesi;

(4) Çdo regjistrim që shfuqizohet pushon së pasuri efekt, që nga data e hyrjes në fuqi të shfuqizimit.

(5) Zyra e Patentave bën shënimet në Regjistrin përkatës dhe publikon shfuqizimin e markës dhe çdo ndryshim tjetër të bërë sipas këtij neni.

K R E U XXVI
EMËRTIMET E ORIGINËS

Neni 93
Emërtimet e origjinës

(1) Emërtimet e origjinës përdoren për të shënuar produktet natyrore, produktet bujqësore, produktet industriale dhe ato artizanale.

(2) Emërtimet e origjinës mbrojnë :

(a) emrat gjeografike të produkteve, vetitë dalluese të të cilave janë kryesisht si rezultat i lokalitetit apo rajonit ku prodhohen ato, në qoftë se këto veti janë pasoja natyrore të klimës ose të tokës ose të procedurave apo proceseve prodhuese të krijuara;

(b) emrin e një produkti i cili gjatë përdorimit për një kohë të gjatë në veprimet ekonomike,

bëhet një tregues përgjithësisht i njohur i origjinës së produktit lidhur me lokalitetin apo rajonin të cilit i përket.

(3) Emërtimet e origjinës nuk mbrojnë emrat gjeografikë, të cilët për shkak të përdorimit për një kohë të gjatë në veprimet ekonomike, përgjithësisht popullarizohen duke tregtuar lloje të veçanta të produkteve.

(4) Zyra e Patentave njeh të drejtën e përdorimit të emërtimit të origjinës së kërkuar mbasi të ketë marrë mendimin e organeve kompetente lidhur me:

(a) produktet që mund të marketohen me emërtimin e origjinës së dhënë;

(b) vendet apo rajonet nga e kanë origjinën produktet e marketuara me emërtimin e origjinës së dhënë;

(c) kërkesat e prodhimit që duhet të plotësojë produkti me qëllim që të marketohet me emërtimin e origjinës;

(d) mënyrën e shënimit të produkteve dhe kërkesa më të hollësishme për të përdorur emërtimin e origjinës së dhënë.

(5) Emërtimi i origjinës mund të vendoset me një nga mënyrat e mëposhtme:

(a) nëpërmjet regjistrimit të emrit gjeografik dhe llojit të produktit me të cilin ka lidhje emri në regjistrin e emërtimeve të origjinës të mbrojtura;

(b) në interes të një personi të huaj, mbi bazën e një marrëveshjeje ndërkombëtare për mbrojtjen reciproke të emërtimeve të origjinës të arritur në Republikën e Shqipërisë.

(6) Emërtimi i origjinës është një e drejtë kolektive dhe mund të përdoret si e tillë vetëm nga ata që prodhojnë apo marketojnë produktin për të cilin është vendosur emërtimi i origjinës.

TË NDRYSHME

KAPITULLI XXVII ZYRA E PATENTAVE

Neni 94

Zyra e Patentave

(1) Zyra e Patentave e Republikës së Shqipërisë është person juridik në varësi të Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë të Republikës së Shqipërisë. Aktiviteti i Zyrës së Patentave përcaktohet dhe rregullohet me anën e këtij ligji dhe Rregullores së Zyrës së Patentave. Kryetari i Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë emëron Drejtorin e Zyrës së Patentave, përcakton strukturën organizative të saj dhe miraton Rregulloren e Zyrës së Patentave. Për të vulosur patentat, dëshmitë e regjistrimit të markave tregtare dhe të dizenjove industriale, si dhe dokumentat e tjera të përcaktuara në Rregulloren e Zyrës së Patentave, kjo Zyrë ka vulën e vet.

Neni 95

Kufizimet ndaj punonjësve të Zyrës së Patentave

(1) Gjatë periudhës së aktivitetit në Zyrën e Patentave, si dhe brenda 1 viti pas përfundimit të punës së tyre në lidhje me Zyrën e Patentave, zyrtarët dhe punonjësit e kësaj Zyre nuk mund të depozitojnë kërkesa për patentë, markë tregtare dhe dizenjo industriale. Ata nuk lejohen që drejtpërdrejt ose tërthorazi (përveç rasteve të trashëgimisë) të marrin në zotërim patentë, markë tregtare ose dizenjo industriale, të miratuar prej Zyrës së Patentave si dhe nuk mund të fitojnë asnjë të drejtë që lind prej tyre.

(2) Zyrtarët dhe nëpunësit e Zyrës së Patentave nuk mund të gëzojnë të drejtën e prioritetit ndaj patentave, regjistrimit të markave tregtare dhe të dizenjove industriale si dhe të kërkesave për patentë, markë tregtare dhe dizenjo industriale, të cilat kanë data më të hershme se sa një vit pasi ata të kenë përfunduar punësimin e tyre në Zyrën e Patentave.

Neni 96

Drejtori i Zyrës së Patentave

(1) Drejtori i Zyrës së Patentave drejton të gjithë aktivitetin e kësaj Zyre dhe ndjek përmbushjen e tërë detyrimeve të përcaktuara në ligj dhe në Rregulloren e Zyrës së Patentave.

(2) Brenda kornizave të këtij ligji, Drejtori i Zyrës së Patentave e përfaqëson Zyrën në Gjykatë, arbitrazh dhe institucionet shtetërore.

Neni 97

Bordi i Apelimit

Për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve në çështjet e patentave, markave tregtare dhe dizenjove industriale, brenda strukturës së Zyrës së Patentave krijohet Bordi i Apelimit, i cili vepron në përputhje me rregullat përkatëse të miratuara prej Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Ministrisë së Drejtësisë.

KAPITULLI XXVIII PËRFAQËSIMI

Neni 98

Përfaqësimi përpara Zyrës së Patentave

(1)(a) Kur paraqitësi i kërkesës për patentë, markë tregtare apo dizenzo industriale emëron (autorizon) një përfaqësues në lidhje me kërkesën e tij, emërimi bëhet ose në vetë kërkesën ose me një deklaratë (autorizim) të veçantë të nënshkruar nga paraqitësi i kërkesës dhe që i dorëzohet Zyrës së Patentave, duke treguar edhe numrin e kërkesës.

(b) Kur pronari i patentës, i regjistrimit të markës tregtare apo të dizenjove industriale autorizon një përfaqësues në lidhje me patentën ose regjistrimin, autorizimi bëhet me një deklaratë të nënshkruar nga pronari i patentës, i regjistrimit të markës tregtare apo të dizenjove industriale, në të cilën tregohet numri i regjistrimit.

(2)(a) Paraqitësi i kërkesës ose pronari i patentës ose i regjistrimit mund të kufizojë fuqinë e përfaqësimit me akte të caktuara.

(b) Në qoftë se paraqitësi i kërkesës apo pronari i patentës ose i regjistrimit bën kufizimin e fuqisë së përfaqësimit pas emërimit të përfaqësuesit, ai duhet të njoftojë për këtë Zyrën e Patentave me anën e një komunikimi me shkrim. Ky kufizim do të ketë vlerë vetëm pasi Zyra e Patentave të ketë marrë njoftimin përkatës.

(3) Personat fizikë dhe juridikë, vendbanimi i përhershëm i të cilëve nuk ndodhet në Republikën e Shqipërisë ose që nuk zotërojnë ndonjë ndërmarrje brenda territorit të saj, përfaqësohen para Zyrës së Patentave vetëm nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të patentave, të cilët duhet të jenë detyrimisht të regjistruar në Zyrën e Patentave në përputhje me nenin 101 të këtij ligji.

(4)(a) Personat fizikë, vendbanimi i përhershëm i të cilëve ndodhet në Republikën e Shqipërisë ose që zotërojnë një ndërmarrje brenda territorit të saj mund të përfaqësohen para Zyrës së Patentave drejtpërdrejt ose nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të patentave, të cilët janë të emëruar prej tyre.

(b) Personat juridikë, vendbanimi i përhershëm i të cilëve ndodhet në Republikën e Shqipërisë ose që zotërojnë një ndërmarrje brenda territorit të saj, mund të përfaqësohen para Zyrës së Patentave nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të patentave, ose nëpërmjet një personi fizik i cili nuk është përfaqësues i autorizuar i patentave, por e drejton ose është i punësuar në këtë person juridik dhe është i autorizuar prej tij si përfaqësues.

Neni 99

Përfaqësuesit e autorizuar të patentave

(1) Përfaqësuesit e autorizuar të patentave janë përfaqësuesit e të gjitha formave të pronës industriale të cilët janë të regjistruar në Zyrën e Patentave. Zyra e Patentave administron Regjistrin e Përfaqësuesve të Autorizuar të Patentave, në të cilin regjistrohen të gjithë këta përfaqësues në përputhje me klauzolat e këtij neni.

(2) Në Regjistrin e Përfaqësuesve të Autorizuar të Patentave mund të regjistrohen personat fizikë ose juridikë, të cilët duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në Rregulloren e Zyrës së Patentave.

(3) Çdo përfaqësues i autorizuar i patentave ka të drejtë të kërkojë të ç'regjistrohet prej Regjistrin të përfaqësuesve të autorizuar të patentave.

(4) Regjistri i përfaqësuesve të autorizuar të patentave ruhet në Zyrën e Patentave dhe është i lejueshëm për t'u shfrytëzuar prej çdo personi të interesuar. Zyra e Patentave publikon rregullisht një listë të përfaqësuesve të autorizuar të patentave.

K R E U XXIX MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE

Neni 100

Përparësia e marrëveshjeve ndërkombëtare

Në qoftë se një marrëveshje ndërkombëtare e nënshkruar prej Republikës së Shqipërisë parashikon dispozita të tjera nga ato që përcaktohen në këtë ligj, atëhere do të zbatohen dispozitat e marrëveshjes ndërkombëtare.

K R E U XXX KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 101

Kundërvajtjet administrative

(1) Çdo person juridik ose fizik, që kryen një shkelje të patentës, markës tregtare ose dizenjot industriale dënohet nga gjykata për kundërvajtje administrative me një gjobë nga 20.000 deri në 100.000 lekë.

(2) Procedurat gjyqësore nuk mund të ndërmerren, në qoftë se ka kaluar një periudhë prej 5 vjetësh nga data e kryerjes së shkeljes.

(3)(a) Në rast përsëritjeje, dënimi maksimal do të dyfishohet.

(b) Përsëritja gjykohet se ka ndodhur, kur brenda 5 vjetëve në vazhdim, kundërvajtësi ka qënë dënuar me një tjetër shkelje të përcaktuar nga paragrafi (1) i këtij neni.

K R E U XXXI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 102

Rregulla

Kryetari i Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë ka të drejtë që herë pas here të miratojë rregulla dhe dispozita të tjera në përputhje me këtë ligj, duke përcaktuar të gjitha çështjet që kërkojnë ose lejohen të përcaktohen, ose të cilat janë të nevojshme ose të dëshirueshme për t'u përcaktuar, në mënyrë që ky ligj të zbatohet me efikasitet dhe që Zyra e Patentave të ketë mundësi të kryejë normalisht aktivitetin e saj.

Neni 103

Fuqia prapavepruese

Të gjitha kërkesat e depozituara në Zyrën e Patentave para hyrjes në fuqi të këtij ligji, trajtohen në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 104
Shfuqizime

- (1) Ditën që ky ligj hyn në fuqi bëhen të pavlefshëm :
- Dekreti i Markave në Prodhim dhe të Tregtisë nr.2490, datë 22.07.1957, ndryshuar me dekretet nr. 3530, datë 2.7.1962 dhe nr.4253, datë 11.4.1967;
 - Nenet 329 - 335 të Kodit Civil ("E drejta e shpikjes dhe racionalizimit"), miratuar me ligjin nr.6340 datë 26.6.1981 dhe 333 (a) miratuar me dekretin nr.7316 datë 1989 dhe të gjithë dispozitat e tjera ligjore që bien në kundërshtim me këtë ligj.
- (2) Të gjitha të drejtat e pronës industriale, që janë kërkuar ose pranuar pranë Byrore së Patentave dhe Markave të Dhomës së Tregtisë, në datën kur hyn në fuqi ky ligj, vazhdojnë të jenë të vlefshme në të njëjtën masë në Republikën e Shqipërisë deri në mbarimin e afateve përkatëse.
- (3) Ditën që hyn në fuqi ky ligj, i gjithë dokumentacioni i Dhomës së Tregtisë në lidhje me aktivitetin e kryer për depozitimin dhe regjistrimin e markave tregtare i kalon në administrim Zyrës së Patentave.

Neni 105
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, me përjashtim të dispozitave të kreu X , të cilat do të hyjnë në fuqi datën e pranimi të Republikës së Shqipërisë në PCT.

Shpallur me dekretin nr.843, datë 12.5.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.